# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria –Vlada-Government***

***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës***
***Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastruktre***
***Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure***

# Monitorimi i zbatimit të Strategjisë 2021-2030 dhe Planit të Veprimit 2021-2023 për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave

## Raporti i parë i progresit të zbatimit

## (Qershor 2021 - Dhjetor 2022)

**Shkurt 2023**

# Përmbledhje ekzekutive

Përgatitja e Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë (në tekstin e mëtejmë - SMIMK) është bërë në bazë të Ligjit për Mbeturina nr. 04/L-060 dhe paraqet hapin e radhës në realizimin e prioriteteve shtetërore për mbrojtjen e mjedisit. Kjo Strategji përcakton objektivat strategjike, objektivat specifike, caqet dhe indikatorët për sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave. Strategjia mbulon një periudhë 10-vjeçare (2021-2030) dhe përfshin një Plan Veprimi 3-vjeçar (2021-2023).

SMIMK synon t'i adresojë mangësitë dhe kufizimet aktuale në sektorin e menaxhimit të mbeturinave duke vendosur dhe realizuar katër objektiva strategjike të cilat luajnë një rol në avancimin e Kosovës përpara drejt potencialeve ekonomike dhe standardeve evropiane të jetesës. Arritjet e zbatimit të SMIMK për periudhën raportuese janë matur në bazë të **4 objektivave strategjike** dhe indikatorëve përkatës të përcaktuar në SMIMK dhe PV-në përkatëse drejt caqeve të përkohshme të vendosura për vitin 2023.

Ky raport i progresit është përgatitur për herë të parë dhe si i tillë mbulon periudhën kohore Qershor 2021 – Dhjetor 2022.

Gjatë periudhës raportuese Qershor 2021- Dhjetor 2022 zbatimi i aktiviteteve të rëndësishme të parapara në SMIMK ka filluar, ku disa nga aktivitetet e parapara kanë përfunduar në tërësi. Në këtë kontekst, nga 54 aktivitete të parapara për periudhën raportuese, 12 aktivitete janë përfunduar në tërësi, 21 aktivitete janë në zbatim e sipër, ndërsa 21 aktivitete të tjera nuk kanë filluar së zbatuari.

Një vonesë e tillë në zbatimin e aktiviteteve ishte kryesisht për shkak të miratimit të vonuar të SMIMK-së në Maj 2021 dhe krijimit të qeverisë së re me 22 Mars 2021. Vlen të theksohet se përderisa finalizimi i Draft Strategjisë ishte bërë në vitin 2019, si rrjedhojë e ndryshimeve të qeverive në atë periudhë kohore, miratimi i Strategjisë është bërë me vonesë dhe kësisoj ka ndikuar negativisht në zbatimin e aktiviteteve me kohë. Për zbatimin e plotë të aktiviteteve të përcaktuara në Planin e Veprimit, gjithashtu duhet të kërkohet mbështetje nga donatorët, duke marrë parasysh burimet e kufizuara financiare nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Vështirësia kryesore e hasur në finalizimin e këtij raporti të progresit, ishte mbledhja e të dhënave, duke pasur parasysh se institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të caktuara me raste edhe nuk u janë përgjigjur kërkesave të MMPHI për raportim.

Figura 1 tregon progresin e përgjithshëm të të gjitha aktiviteteve të planifikuara nga SMIMK për periudhën aktuale raportuese.




**Figura 1. Progresi i zbatimit të Strategjisë, Qershor 2021 - Dhjetor 2022**

Statusi i zbatimit të aktiviteteve dhe projekteve të ndryshme të identifikuara nga SMIMK në kuadër të secilit objektiv strategjik dhe specifik është detajuar në kapitullin 2 dhe është përmbledhur në Aneksin 2, ndërsa orari kohor i aktiviteteve të zbatuara është paraqitur në Aneksin 3 të këtij Raporti.

Statusi i indikatorëve dhe arritja e caqeve është përmbledhur në Tabelën 1 të faqes në vijim:

**Tabela 1. Përmbledhje e arritjes së indikatorëve (dhjetor 2022)**

| № | Objektivat | Indikatori i arritjeve | Baza në vitin 2020 | Caku | Statusi në vitin 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| **I.** | **Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i një gjenerate të re të shërbimeve dhe infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbeturinave** | | | | |
| I.1. | Objektivi specifik: Ofrimi i shërbimeve të rregullta dhe të besueshme të mbledhjes së mbeturinave të ngurta komunale për tërë popullatën | Indikatori: Përqindja e popullsisë së përgjithshme me qasje në shërbime adekuate dhe të rregullta të mbledhjes së mbeturinave komunale | 74% | 80% në vitin 2023 | Pritjet sipas AMMK jane qe mbulimi me sherbim te arrij rreth 95% bazuar n bazuar në trendin e rritjes qe nga viti 2018 rezultaet do te shihen pas raportimit te komunave per vitin 2022 deri me 31 mars 2023 |
| I.2. | Objektivi specifik: Zhvillimi i rrjetit të integruar të qendrave të menaxhimit të mbeturinave | Indikatori: Përqindja e gjithsej mbeturinave të ngurta komunale të prodhuara që menaxhohen në qendra të kontrolluara | 40% | 60% në vitin 2023 | 78% |
| I.3. | Objektivi specifik: Zhvillimi i sistemeve për kontrollimin dhe menaxhimin e mbeturinave të tjera. | Indikatori: Përqindja e MND-ve të deponuara në deponi të caktuara dhe të ricikluara | 0 | 3 qendra të MNRr në vitin 2024 | 0 |
| | | Indikatori: Disponueshmëria e planeve të menaxhimit të mbeturinave të sektorit | Nuk ka PMM për sektor | 2 plane në vitin 2023 | 0 |
| **II.** | **Objektivi strategjik 2: Profesionalizimi i sektorit të menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave** | | | | |
| II.1. | Objektivi specifik: Vazhdimi i ndërtimit të kapaciteteve profesionale në sektorin publik dhe privat | Indikatori: Kapaciteti profesional në sektorin publik dhe privat | Ofrohet nga partnerët zhvillimorë | Raportet e monitorimit | Mbështetje e vazhdueshme për ndërtimin e kapaciteteve |
| II.2. | Objektivi specifik: Caktimi i një kodi industrial për sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave në statistikat kombëtare | Indikatori: Përfshirja e profesioneve dhe bizneseve deri në vitin 2023 | Nuk ka njohje | Përfshirja e profesioneve deri në vitin 2023 | 0 |
| | | Indikatori: Organi i industrisë themelohet deri në vitin 2023 | Nuk ka organ të themeluar | Organi i industrisë themelohet deri në vitin 2023 | 0 |
| II.3. | Objektivi specifik: Promovimi i hulumtimit dhe zhvillimit në universitete | Indikatori: Kursi ose moduli MIMN-së krijohet në universitet deri në vitin 2025 | Nuk ka kurs specifik për MIMN në dispozicion | 1 kurs i miratuar deri në vitin 2025 | 0 |
| **III.** | **Objektivi strategjik 3: Forcimi i rregullimit dhe kontrollit në sektorin e menaxhimit të mbeturinave duke i plotësuar boshllëqet dhe duke i qartësuar mekanizmat e zbatimit** | | | | |
| III.1. | Objektivi specifik: Krijimi i një sistemi informativ funksional për menaxhimin e mbeturinave | Indikatori: SIM-i është funksional në vitin 2021 dhe i qasshëm për publikun në vitin 2023 | AKMM-ja publikon një raport vjetor për MMN-në | SIM ekziston dhe është i qasshëm në vitin 2023 | 0 |

| № | Objektivat | Indikatori i arritjeve | Baza në vitin 2020 | Caku | Statusi në vitin 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| III.2. | Objektivi specifik: Zgjerimi i sistemit të dhënies së licencave dhe lejeve për menaxhimin e mbeturinave për t'i mbuluar të gjitha mbeturinat, operatorët dhe qendrat e menaxhimit të mbeturinave. | Indikatori: Mbulimi i plotë i dhënies së licencave dhe lejeve deri në vitin 2027 | Mbulimi i pjesshëm i licencimit dhe lejeve të MM | 50% e qendrave janë të mbuluara në vitin 2023 | 0 |
| | | Indikatori: Plani i Menaxhimit të Mbeturinave Industriale publikohet deri në vitin 2022 | Nuk ka plan | 1 plan | 0 |
| III.3. | Objektivi specifik: Forcimi i mekanizmave zbatues, ndërlidhur komunat dhe inspektoratet. | Indikatori: Mekanizmat dhe procedurat e zbatimit rishikohen deri në vitin 2022, ndërsa për të paktën 75% të shkeljeve të raportuara ekzistojnë mekanizmat dhe procedurat përkatëse të zbatimit që përdoren nga autoritetet kompetente deri në vitin 2024 | Mekanizmat e zbatimit dhe realizimit nuk janë në zbatim | 1 raport i rishikimit në vitin 2023 | 0 |
| **IV.** | **Objektivi strategjik 4: Promovimi i vlerave dhe praktikave të një ekonomie qarkore** | | | | |
| IV.1. | Objektivi specifik: Ngritja e vetëdijes për rëndësinë dhe dobitë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave. | Indikatori: Rezultatet e fushatave publikohen në vitet 2024, 2027 dhe 2030 | Nuk realizohet ndonjë fushatë e veçantë e vetëdijesimit | 1 vlerësim i ndikimit të fushatës | 0 |
| IV.2. | Objektivi specifik: Stimulimi i risive në parandalimin e mbeturinave | Indikatori: Raundi i parë i aplikimit për grante për ide inovative përfundon në vitin 2023 | Asnjë sistem granti nuk është krijuar | Skema e granteve të inovacionit në vitin 2023 | 0 |
| IV.3. | Objektivi specifik: Krijimi i sistemeve të ripërdorimit dhe riciklimit të bazuara në konceptin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit. | Indikatori: Deri në vitin 2024– mekanizmat e PZP-së aplikohen për 4 kategori të produkteve/fraksione të mbeturinave (ambalazhi, pajisjet elektrike dhe elektronike, bateritë, automjetet e jashtëpërdorimit) | Nuk zbatohet asnjë mekanizëm i PZP-së | Ekziston 1 skemë e PZP-së | 0 |

# 1 Hyrje

Ky Raport Vjetor i Progresit është përgatitur nga Divizioni për Mbeturina dhe Kimikate (DMK) i Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave i MMPHI-së. Në këtë drejtim, MMPHI sipas Strategjisë e ka rolin udhëheqës si dhe gjithashtu është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe drejtimin e zbatimit, monitorimit dhe raportimit të SMIMK. MMPHI për qëllim të monitorimit të zbatimit të SMIMK - ka themeluar grupin ndërministror për monitorimin e zbatimit të Strategjisë ku pjesë e grupit janë përfaqësues nga Zyra e Planifikimit Strategjik të Zyrës së Kryeministrit, përfaqësues të ministrive të linjës sikurse: MAPL; ME; MFPT; MAShTI; MBPZhR; MF; MPB; si dhe përfaqësues të KMDK; AMMK; ASK.

## 1.1 Qëllimi i raportit

Qëllimi kryesor i këtij raporti është monitorimi i progresit të zbatimit të SMIMK dhe Planit të Veprimit (PV) përkatës dhe ofrimi i informacioneve dhe të dhënave për mekanizmat si më poshtë:

1. Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI),
2. Trupin Koordinues Ndërministror,
3. Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT),
4. Zyrën e Planifikimit Strategjik (ZPS) dhe
5. Qeverinë e Kosovës.

Raporti do t'u shërbejë institucioneve përkatëse të lartpërmendura si një mjet që synon të:

- Kontrollojë nëse zbatimi i SMIMK është në përputhje me zotimet politike, teknike dhe financiare të bëra nga QRK-ja ndaj qytetarëve të Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare.
- Analizojë problemet e hasura në mënyrë që të përcaktohen zgjidhjet më të mira të tyre, duke u dhënë përparësi ndërhyrjeve përkatëse që do të zbatohen gjatë periudhës afatshkurtër dhe afatmesme në vijim për të arritur objektivat e SMIMK dhe PV-së dhe rezultatet e pritura, duke mundësuar rishikimin e SMIMK si dhe zhvillimin e planit të veprimit 2024 – 2026 për të marrë parasysh kontekstin e modifikuar ndërkombëtar dhe vendor si dhe nevojat dhe sfidat e sektorit të menaxhimit të mbeturinave.
- Çojë në vendime për të reduktuar rreziqet dhe për të përmirësuar zbatimin e SMIMK dhe PV-së.
- Korrigjoj dhe identifikojë projektet prioritare që do të konsiderohen në Planin e ardhshëm të Veprimit 2024-2026 me buxhetin dhe afatet kohore përkatëse, që do të zbatohen në periudhën e ardhshme të planifikimit në përputhje me burimet njerëzore dhe financiare në dispozicion.

Në këtë kuadër, dokumentet referuese të monitoruara janë SMIMK 2021-2030 dhe Plani përkatës i Veprimit 2021-2023, miratuar nga Qeveria me datë 28.05.2021 (Vendimi nr. 08/14). SMIMK është dokument kryesor referues për donatorët ndërkombëtarë (IFN-të) për të planifikuar dhe zbatuar veprimet e tyre, duke alokuar buxhetin e nevojshëm me institucionet drejtuese përgjegjëse dhe në veçanti me MMPHI-në për zbatimin e aktiviteteve përkatëse në Planin e Veprimit. Ky raport vjetor është i pari i përgatitur për të matur zbatimin e SMIMK, prandaj i njëjti mbulon periudhën kohore Qershor 2021- Dhjetor 2022, duke pasur parasysh se Strategjia është miratuar në fund të Maj 2021. Si rrjedhojë, periudha raportuese konsiderohet të jetë një vit e gjysëm kalendarik. Raporti i ardhshëm i Monitorimit do të mbulojë periudhën Janar – Qershor 2023. Në përputhje me pikën 8.2.2 dhe Shtojcën 9 të "*Manualit për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve*

*Strategjike dhe Planeve të tyre të Veprimit*" të finalizuar nga ZPS-ja në vitin 2019, fokusi kryesor i këtij Raporti Vjetor është:

- Arritja e objektivave krahasuar me caqet e indikatorëve
- Përfundimi në kohë i veprimeve të ndërmarra
- Përdorimi i burimeve financiare
- Pengesat kryesore të zbatimit
- Masat korrigjuese

Pesë komponentët e mësipërm të monitorimit përbëjnë metodologjinë kryesore të përdorur për përgatitjen e këtij Raporti Vjetor. Përveç kësaj, me mbështetjen e BE-së dhe GIZ-it, MMPHI ka zhvilluar mjetin e monitorimit të SMIMK dhe PV. Ky mjet monitorimi ndihmon MMPHI për të identifikuar dhe matur zbatimin e arritjes së caqeve dhe objektivave, përfundimin në kohë të aktiviteteve dhe përdorimin e resurseve financiare. Kapitujt 2 dhe 3 të këtij Raporti janë përgatitur duke përdorur funksionalitetin e këtij mjeti monitorues.

Plani i Veprimit, si një mjet thelbësor zbatues, identifikon institucionet udhëheqëse dhe ato mbështetëse për secilin prej aktiviteteve përkatëse. Si rrjedhojë, përgjegjësia për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve specifike i takon secilit institucion të caktuar. Në këtë kontekst, MMPHI-ja si organ koordinues është përgjegjëse për koordinimin e përgjithshëm ndërmjet institucioneve zbatuese dhe siguron që afatet kohore dhe aktivitetet janë zbatuar siç kanë qenë të përcaktuara në Planin e Veprimit. Funksionet kryesore të institucioneve zbatuese të SMIMK janë paraqitur në tabelën 2 të mëposhtme.

**Tabela 2. Struktura e Menaxhimit të Zbatimit të SMIMK-së**

| Institucioni | Funksionet kryesore |
|---|---|
| MMPHI-ja | • E harton Strategjinë dhe Planin e Veprimit<br>• I udhëzon të gjithë partnerët zbatues për përgjegjësitë e tyre në kuadër të Planit të Veprimit<br>• E krijon një mekanizëm efektiv të monitorimit dhe raportimit dhe e siguron përdorimin e tij<br>• Mbledh informata nga partnerët zbatues për afatet kohore, caqet dhe statusin e zbatimit<br>• I përgatit dokumentet e nevojshme për raportim (shih më poshtë)<br>• E organizon Grupin Punues për MMN-në dhe i ofron funksionet e sekretariatit<br>• E siguron shkëmbimin dhe bashkëpunimin midis të gjithë partnerëve zbatues<br>• I inicion diskutimet për progresin e zbatimit dhe azhurnimin ose riplanifikimin e Planit të Veprimit |
| Grupi punues për MM-në | • Kryen shkëmbime të rregullta për ta diskutuar progresin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit<br>• I identifikon sfidat dhe vështirësitë dhe propozon masa korrigjuese për partnerët zbatues<br>• I shqyrton dhe miraton raportet e progresit dhe monitorimit<br>• E nxit bashkëpunimin midis të gjithë partnerëve zbatues |
| Zyra për Planifikim Strategjik | • U ofron mbështetje metodologjike MMPHI-së dhe partnerëve zbatues në hartimin, monitorimin dhe raportimin e Strategjisë<br>• Merr pjesë në Grupin Punues për MM<br>• I rishikon raportet dhe e bën një vlerësim strategjik të rrezikut dhe përshtatjes me aktet strategjike kombëtare gjithëpërfshirëse<br>• E integron progresin e strategjisë së MMN-së në raportimin kombëtar për dorëzim tek Komiteti i Planifikimit Strategjik |
| Komiteti për Planifikim Strategjik | • I shqyrton dhe miraton raportet e rregullta, nëse çështjet nuk i ka zgjidhur Grupi Punues për MM<br>• Vendos për masat korrigjuese për ta siguruar zbatimin e shëndoshë të strategjisë<br>• I zgjidh çështjet në bashkërendim dhe vendimmarrje midis partnerëve zbatues, nëse zgjidhjet kanë dështuar në nivel të Grupit Punues për MMN |
| MAPL | • E mbështet shpërndarjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit nëpër komuna<br>• E bashkërendon mbështetjen e qeverisë për komunat në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit<br>• Merr pjesë në Grupin Punues për MMN<br>• I bashkërendon masat e zhvillimit të kapaciteteve për komunat e parashikuara në Planin e Veprimit me masa të tjera në mbështetje të administratave komunale |

| Institucioni | Funksionet kryesore |
|---|---|
| | • E mbështet sigurimin e buxheteve adekuate në buxhetet komunale |
| Komunat | • Në bazë të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, zhvillojnë dhe zbatojnë Planet Komunale ose Rajonale për Menaxhimin e Mbeturinave<br>• E sigurojnë zbatimin me kohë dhe efikas të veprimeve që u janë atribuuar<br>• Raportojnë për progresin sipas kërkesës së MMPHI-së dhe AMMK-së<br>• Ia bëjnë me dije pengesat dhe sfidat ndaj zbatimit në kohë të veprimeve MMPHI-së dhe/ose Grupit Punues për MMN<br>• E sigurojnë bashkëpunimin e ngushtë me KMDK-në, KRM-në dhe/ose ofruesit e tjerë të shërbimeve<br>• Marrin pjesë në Grupin Punues për MMN-të, përmes përfaqësuesit kombëtar të tyre – AKK-së |
| AMMK-ja | • E mbështet MMPHI-në në mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave për zbatimin e Strategjisë<br>• I mbështet komunat në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave<br>• Merr pjesë në Grupin Punues për MMN |
| KMDK | • Merr pjesë në Grupin Punues për MMN<br>• E siguron zbatimin me kohë dhe efikas të veprimeve që i janë atribuuar<br>• E siguron monitorimin dhe raportimin me kohë dhe gjithëpërfshirës për realizimin e veprimeve dhe për caqet dhe performancën e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave<br>• Ia bën me dije pengesat dhe sfidat ndaj zbatimit në kohë të veprimeve MMPHI-së dhe/ose Grupit Punues për MM |
| KRM | • Merr pjesë në Grupin Punues për MMN-të përmes përfaqësimit të tyre kombëtar nga PAMKOS<br>• E siguron zbatimin me kohë dhe efikas të veprimeve që i janë atribuuar<br>• E siguron monitorimin dhe raportimin me kohë dhe gjithëpërfshirës për realizimin e veprimeve dhe për caqet dhe performancën e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave<br>• Ia bën me dije pengesat dhe sfidat ndaj zbatimit në kohë të veprimeve MMPHI-së dhe/ose Grupit Punues për MM |
| Ofruesit e shërbimeve | • E sigurojnë zbatimin me kohë dhe efikas të veprimeve që u janë atribuuar<br>• E sigurojnë raportimin me kohë dhe gjithëpërfshirës për performancën e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave |

## 1.2. Objektivat në përputhje me politikat e BE-së dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Duke pasur parasysh se integrimi në BE mbetet prioriteti më i lartë i Qeverisë, janë bërë përpjekje nga MMPHI-ja për të transpozuar tutje *acquis* të BE-së dhe direktivat përkatëse në legjislacionin vendor. Për këtë qëllim, në vlerësimet e BE-së, respektivisht në Raportin vjetor të BE-së për Kosovën dhe objektivat për zhvillim të qëndrueshëm, gjithmonë merren parasysh aktivitetet që kanë të bëjnë me monitorimin e zbatimit të politikave pa përjashtuar zbatimin e SMIMK-së dhe projekteve prioritare mjedisore përkatëse.

Në përputhje me Dokumentin e Punës të Stafit të Komisionit Evropian "***Raporti i Kosovës 2021***" që shoqëron Komunikatën e vitit 2021 për Politikën e Zgjerimit të BE-së, kapitulli 5.3.4 Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike: "*BE-ja promovon veprim të fortë klimatik, zhvillim të qëndrueshëm dhe mbrojtje të mjedisit. Ligji i BE-së përmban dispozita që adresojnë ndryshimet klimatike, cilësinë e ujit dhe ajrit,* ***menaxhimin e mbeturinave****, mbrojtjen e natyrës, ndotjen industriale, kimikatet, zhurmën dhe mbrojtjen civile*". Sipas këtij Raporti të BE-së, në vitin 2021 Kosova ishte ende në një **fazë të hershme të përgatitjes** për mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe është arritur **progres i kufizuar** në raportimin mjedisor.

Përderisa "***Raporti i Kosovës 2022"*** për **Politikën e Zgjerimit të BE**-së përcakton se Kosova duhet të rrisë angazhimin e saj politik për të adresuar degradimin e mjedisit dhe sfidat e ndryshimeve klimatike dhe të përmirësojë ndjeshëm zbatimin e legjislacionit të saj, për ta harmonizuar atë me Agjendën e Gjelbër për objektivat e Ballkanit Perëndimor. Shumica e rekomandimeve nga raporti i mëparshëm janë ende të pazbatuara. Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet: të rrisë

mbulimin e grumbullimit të mbeturinave, të zbatojë reduktimin e gjerë, riciklimin ndarës dhe ripërdorimin e mbeturinave, të trajtojë në mënyrë efektive çështjen e deponive të paligjshme dhe të vë në funksion masat e ekonomisë rrethore për reduktimin e mbeturinave, të zhvillojë dhe miratojë plane të menaxhimit të integruar ndërkomunal të mbeturinave dhe të krijojë një sistem për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesve."

Në lidhje me të gjeturat e Raporteve për Kosovën për vitin 2021 dhe vitin 2022, në sektorin e menaxhimit të mbeturinave janë ndëmarrë veprime përkatëse dhe gjendja është si vijon:
- në vitin 2021 **përqindja e popullsisë së përgjithshme me qasje në shërbimet adekuate dhe të rregullta të mbledhjes së mbeturinave komunale** tashmë ka arritur cakun prej 90.2%, ku 80% ishte caktu për vitin 2023, gjë e cila demonstron detyrat e zbatuara në mënyrë efektive nga MMPHI-ja, MAPL-ja, komunat, KMDK-ja dhe IFN-të, në veçanti GIZ dhe KfW, për këtë qëllim
- çështja e deponive ilegale është trajtuar seriozisht me miratimin dhe ndarjen e burimeve të nevojshme financiare, edhe nga IFN-të, ku gjithsej janë mbyllur 300 deponi ilegale gjatë periudhës 2020-2021 në komuna të ndryshme të Kosovës
- për sa i përket qasjes në infrastrukturën për ndarjen në burim të mbeturinave, në vitin 2021 është mundësuar qasje për 30,162 ekonomi familjare
- nga 11 komuna sa ishin në vitin 2020 - gjithsej 23 komuna gjatë vitit 2022 kanë zbatuar masa për ndarjen në burim të materialeve të riciklueshme. Pra ka një progres të konsiderushëm në këtë drejtim
- për herë të parë në korrik të vitit 2022 - Qendra e Kompostimit në Prishtinë është funksionalizuar
- 1858 pajisje të kompostimit shtëpiak janë shpërndarë nga BE/GIZ në kuadër të Skemës së Grantit të Performancës – Mjedisi i Pastër vetëm gjatë vitit 2022

Për sa i përket paraqitjes së ekonomisë qarkore, MMPHI në konsultim me palët e përfshira në proces, konsideron se gjatë vitit 2023 duhet të bëhet rishikimi i SMIMK dhe zhvillimi i Panit të Veprimit 2024-2026 për të përfshirë targetet e riciklimit në SMIMK si dhe për të mundësuar një qasje më të lehtë drejtë ekonomisë qarkore përmes projekteve dhe masave specifike.

Për sa i përket dispozitave ligjore për përgjegjësinë mjedisore, dëmin dhe krimin; zbatimin e parimit 'ndotësi paguan' dhe zhvillimin e një fushate të përhershme për ndërgjegjësimin e publikut për mbrojtjen e mjedisit,të gjitha këto çështje tashmë janë konsideruar në kuadër të prioriteteve kryesore të MMPHI-së. Në veçanti, MMPHI-ja gjatë periudhës raportuese ka punuar intenzivisht në ndryshimin e ligjit për mbeturina. Me miratimin e Ligjit Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina nga Kuvendi i Kosovës, është krijuar baza ligjore për krijimin e Sistemit të Rimbursimit të Depozitës si dhe është krijuar baza ligjore për krijimin e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit. Në këtë drejtim, ligji i ri po ashtu ka përcaktuar dispozitat kundërvajtëse i cili është harmonizuar me Ligjin për Kundërvajtje. Gjatë periudhës raportuese, MMPHI ka hartuar Projekt Udhëzimin Administrativ të ri ***për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit*** i cili është në pajtim me Acquis të BE-së. Duhet theksuar gjithashtu se të dyja këto akte normative transpozojnë direktivat përkatëse të BE-së, **duke kaluar nga 47% e normës së transpozimit në vlerën 98%**, pra duke transpozuar edhe përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit dhe parimin 'ndotësi paguan' në legjislacionin vendor. Projektudhëzimi Administrativ i ka kaluar të gjitha procedurat e konsultimeve ndërministrore dhe konsultimeve me publikun.

Ndërkaq, duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërkomunal në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, gjatë vitit 2021 janë inicuar konsultime me të gjitha komunat e

Republikës së Kosovës për të hyrë në bashkëpunim ndërkomunal. Gjatë muajit Maj të vitit 2022 me mbështetjen e GIZ-it, është realizuar vizitë studimore në Turqi me të gjithë kryetarët e komunave për të mësuar më tepër rreth mundësive dhe përftimeve që sjellë bashkëpunimi ndërkomunal. Në vitin 2022, janë nënshkruar Memorandumet e Mirëkuptimit në mes të kryetarëve të rajoneve si në vijim: Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe Mitrovicë, përderisa rajoni i Pejës vetëm se e ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit në vitin 2020.

Nënshkrimi i këtyre Memorandumeve të Mirëkuptimit, paraqet hapin e parë dhe më të rëndësishëm në përgatitjen e planeve të menaxhimit të integruar ndërkomunal të mbeturinave. Në këtë drejtim, të gjitha këto rajone të lartëcekura i kanë krijuar mekanizmat/trupat punues për përgatitjen e procesit për hyrje në bashkëpunim ndër-komunal.

**Për sa i përket nevojës dhe përpjekjeve për ngritjen dhe furnizimin me pajisje moderne të sistemit për grumbullimin e ndarë dhe riciklimin e mbeturinave** ky është një nga prioritetet kryesore për Qeverinë, MMPHI dhe Komunat.

Për Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm, duhet të kemi parasysh se disa indikatorë lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me sektorin e mbeturinave, dhe në veçanti 4 indikatorët e mëposhtëm janë synuar në mënyrë të veçantë në SMIMK: 11.6.1 për mbeturinat e ngurta komunale, 12.3.1 për mbeturinat e ushqimit, 12.4.2 për mbeturinat e rrezikshme dhe 12.5.1 për normën e riciklimit. Prandaj, indikatorët të përfshirë në SMIMK synohen drejtpërdrejt në përmbushjen e OZHQ-ve.

# 2. Progresi në zbatimin e objektivave strategjikë

## 2.1. Progresi kundrejt Objektivit Strategjik 1: Zhvillimi i një gjenerate të re të shërbimeve dhe infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbeturinave

Siç është identifikuar në SMIMK, investime publike të vazhdueshme në shërbime dhe infrastrukturë nevojiten për të menaxhuar fraksionet e mbeturinave komunale dhe disa fraksione të tjera të mbeturinave. Në total, Plani i Veprimit përfshin **23 aktivitete** për të mbështetur zbatimin e këtij objektivi strategjik. Figura 2 më poshtë tregon progresin e përgjithshëm për periudhën aktuale të raportimit:




**Figura 2. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të Objektivit Strategjik 1**

Arritja e këtij objektivi strategjik është planifikuar të arrihet me zbatimin e tri objektivave specifike:

- Ofrimi i shërbimeve të rregullta dhe të besueshme të mbledhjes së mbeturinave të ngurta komunale për tërë popullatën
- Zhvillimi i rrjetit të qendrave të menaxhimit të integruar të mbeturinave
- Zhvillimi i sistemeve për kontrollimin dhe menaxhimin e mbeturinave të tjera

### 2.1.1. Objektivi specifik 1.1: Ofrimi i shërbimeve të rregullta dhe të besueshme të mbledhjes së mbeturinave të ngurta komunale për tërë popullatën

Komunat dhe kompanitë e licencuara janë përgjegjëse për organizimin e mbledhjes së mbeturinave komunale. Kompanitë që merren me mbledhjen e mbeturinave duhet të pajisen me leje perkatëse mjedisore për ta bërë këtë në bazë të kritereve të Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina si dhe Ligjit Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina. Progres i konsiderueshëm është bërë në zgjerimin e mbulimit të shërbimeve të mbledhjes, që raportohet të jetë mbi 90.2% e popullsisë në vitin 2021, duke **përmbushur kështu cakun e ndërmjetëm për vitin 2023**, por jo ende 100% (caku për vitin 2030). Në zonat urbane, mbeturinat mblidhen përmes pikave të përbashkëta të mbledhjes (kontejnerët), ndërsa në zonat rurale mbledhja bëhet kryesisht derë më derë. Frekuenca e mbledhjes së mbeturinave ndryshon sipas qytetit, rajonit dhe sipas zonës urbane dhe rurale.

Figura 3 tregon progresin e përgjithshëm të zbatimit të këtij objektivi specifik.




**Figura 3. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të Objektivit Specifik 1.1**

Tabela 3 përshkruan katër aktivitetet e planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese qershor 2021 – dhjetor 2022.

**Tabela 3. Statusi i aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, OSp 1.1**

| Nr. | Aktiviteti | Përgjegjës | Statusi i progresit | Buxheti i shpenzuar |
|---|---|---|---|---|
| 1.1.1 | Zbatimi i granteve të performancës sipas IKP-ve për shërbimet e mbeturinave komunale | MMPHI | plotësisht i zbatuar | 4,521,950 |
| 1.1.1 a | Asistenca teknike për zbatimin e granteve të performancës sipas IKP-ve për shërbimet e mbeturinave komunale | BE/GDC (BGjZh) | plotësisht i zbatuar | 163,330 |
| 1.1.2 | Zgjerimi i shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave | KOM | pjesërisht i zbatuar | 25,000 |
| 1.1.3 | Mbështetje për të gjitha komunat, për t'i realizuar shërbimet themelore të menaxhimit të mbeturinave në përputhje me ligjin drejt qëndrueshmërisë | BE/GDC (BGjZh) | pjesërisht i zbatuar | 141.500 |

**Është ofruar asistencë teknike në zbatimin e Grantit të Performancës Komunale - Mjedis i pastër,** institucional dhe strukturor. GIZ ka mbështetur AMMK-në në hartimin e shablloneve të standardizuara të raportimit, duke çuar në struktura të standardizuara të raportimit si dhe krijimin institucional të Indikatorëve të Performancës në menaxhimin e mbeturinave. Janë mbajtur një sërë trajnimesh dhe takime për kapacitetin e ZMM-ve, DSHPK-ve dhe KRM-ve për të shfrytëzuar shabllonet e raportimit.

Gjithsej 28 **komuna janë mbështetur nga BE/GDC (BGjZh)** në hartimin e planeve të tyre për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale dhe rregulloreve për menaxhimin e mbeturinave. Planet komunale ndër të tjera adresojnë edhe çështjet që kanë të bëjnë me përcaktimin e tarifave dhe llogaritjes së kostos.

Pra, ky objektiv specifik parasheh gjithsej 4 aktivitete nga të cilat 2 janë zbatuar plotësisht që kanë të bëjnë me: zbatimin e grantit të përformancës sipas indikatorëve kryesorë për shërbimet komunale të mbeturinave, si dhe asistenca teknike për zbatimin e grantit të lartcekur.

Ndërsa zgjerimi i shërbimit të mbledhjes së mbeturinave si dhe mbështetja për të gjitha komunat në realizimin e shërbimeve themelore të menaxhimit të mbeturinave janë aktivitete të cilat janë në zbatim e sipër si dhe përfundimi i tyre bëhet në momentin e arritjes së mbulimit të plotë të shërbimit në vend.

**Indikatori përkatës për këtë objektiv specifik**:

- *Përqindja e popullsisë së përgjithshme me qasje në shërbime adekuate dhe të rregullta të mbledhjes së mbeturinave komunale – 80% deri në vitin 2023*. Siç është përmendur tashmë, caku i ndërmjetëm është arritur në vitin 2020.

Si përfundim, nuk priten pengesa apo sfida me zbatimin e aktiviteteve dhe me arritjen e këtij objektivi specifik.

## 2.1.2. Objektivi specifik 1.2: Zhvillimi i rrjetit të qendrave të menaxhimit të integruar të mbeturinave

Sistemi aktual i deponimit të mbeturinave në vend po përballet me sfida. Deponitë rajonale në Pejë, Prizren dhe Gjilan duhet të përmirësohen. Deponia e Mirashit në Obiliq është ende në funksion përkundër ndikimeve të saj negative në mjedis.

Me mbështetjen e donatoreve  deponia rajonale e Pejës është në rindërtim e sipër me një fazë të re të deponisë që do të ndërtohet sikurse sqarohet më poshtë.

Sa i përket **rehabilitimit dhe eliminimit të deponive ilegale dhe të pakontrolluara**, numri i deponive ilegale është zvogëluar falë përpjekjeve të shumë komunave të Kosovës.




**Figura 4. Numri i deponive ilegale**

Përpjekje të mëtejme janë në zbatim sepse mbyllja e deponive ilegale mbetet brenda prioriteteve kryesore të SMIMK-së nën zbatim. Komunat raportuan se 300 deponi të tjera ilegale u mbyllën në periudhën 2020-2021, duke arritur cakun e pritshëm.. Të dhënat e mbledhura në teren nga AMMK, tregojnë se në vitin 2022 numri i deponive ilegale është gjithsej 763. Të dhënat lidhur me numrin e deponive ilegale do të zyrtarizohen me publikimin e raportit vjetor të sektorit të menaxhimit të mbeturinave i cili publikohet në tre mujorin e parë të vitit 2023.

Figura 5 më poshtë tregon progresin e përgjithshëm të zbatimit të këtij objektivi specifik.




**Figura 5. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të objektivit specifik 1.2**

Tabela 4 përshkruan aktivitetet e planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022.

**Tabela 4. Statusi i aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, OSp 1.2**

| Nr. | Aktiviteti | Përgjegjës | Statusi i progresit | Buxheti i shpenzuar |
|---|---|---|---|---|
| 1.2.1 | Studimi i fizibilitetit dhe dizajni për transfer stacionet dhe qendrat e ndarjes në Klinë, Istog, Skenderaj, Novobërdë | KOM | pjesërisht i zbatuar | 0 |
| 1.2.2 | Ndërtimi i transfer stacioneve dhe qendrave të ndarjes në Klinë, Istog, Skenderaj, Novobërdë | KOM | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 1.2.4 | Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e transfer stacionit në Malishevë | KOM | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 1.2.5 | Ndërtimi i transfer stacionit në Malishevë | KOM | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 1.2.7 | Studimi i fizibilitetit për transfer stacionin në Ferizaj | KOM | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 1.2.10 | Studimi i fizibilitetit për përmirësimin dhe zgjerimin e deponisë ekzistuese në Pejë | KOM | plotësisht i zbatuar | 200,000 |
| 1.2.11 | Përmirësimi dhe zgjerimi i deponisë ekzistuese në Pejë | KOM | pjesërisht i zbatuar | 0 |
| 1.2.12 | Mbikëqyrja për përmirësimin dhe zgjerimin e deponisë ekzistuese në Pejë | KOM | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 1.2.13 | Përmirësimi dhe zgjerimi i deponisë ekzistuese në Dragash | KOM | pjesërisht i zbatuar | 100,242 |
| 1.2.15 | Studimi i fizibilitetit për vlerësimin e deponisë dhe zhvillimin e konceptit në Mirash, Obiliq | MMPHI[1] | pjesërisht i zbatuar | 70,000 |
| 1.2.16 | Përmirësimi i gjendjes teknike dhe operative në deponinë e rajonit të Prishtinës në Mirash - Obiliq | KMDK | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 1.2.18 | Përmirësimi dhe zgjerimi i deponisë së Gjilanit | KMDK | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 1.2.30 | Eliminimi ose rehabilitimi i akumulimeve të paligjshme dhe të pakontrolluara të mbeturinave | KOM | pjesërisht i zbatuar | 482,944 |
| 1.2.30a | Asistenca teknike për pikën 1.2.20 | BE/GDC (BGjZh) | plotësisht i zbatuar | 10,000[2] |

Termat e Referencës për ndërtimin e transfer stacionit të Istogut janë përgatitur.

Për **"Përmirësimi dhe zgjerimi i deponisë ekzistuese në Pejë"**, periudha e parashikuar e zbatimit është deri më 01.01.2024. Në vitin 2019, Komunës së Pejës iu konfirmua se fondet e BE-së do të përdoren për zgjerimin dhe rehabilitimin e deponisë ekzistuese, e cila do t'u shërbejë komunave të rajonit të Dukagjinit. Nga informacionet e marra, për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia COVID-19 dhe krizave të fundit për furnizimin me produkte të caktuara, çmimet përkatëse të materialeve të ndërtimit janë rritur ndjeshëm (druri, metali, energjia, paisjet punuese dhe makineria e importuar etj). Prandaj, kostot e planifikuara fillimisht janë më të ulëta se kostoja që do të jetë

[1] Megjithëse SMIMK ka identifikuar KfW si institucion përgjegjës, Qeveria e Kosovës ka marrë përsipër aktivitetin 1.2.15.

[2] 44,000 Euro janë shpenuar nga BE/GDC(BGjZh) në (1.2.20a) Mbështetje teknike për 1.2.20, përtej buxhetit të parashikuar prej 10.000 EUR

efektivisht e nevojshme për të përfunduar realizimin e këtij projekti i cili rrjedhimisht është ngrirë për të rishikuar çmimet. Po ashtu, arsye tjetër e vonesës është edhe mungesa e konfirmimit për pagesën e shpenzimeve operative të deponisë. Ky projekt do të mund të financohej nga IPA 2022. Në këtë drejtim, Komuna e Pejës ka filluar punën për zbatimin e këtij aktiviteti ku gjatë vitit 2023 do të angazhohet konsulencë për vlerësimin e gjendjes ekzistuese përfshi edhe studimin e fizibilitetit tashmë të përfunduar. Bazuar në këtë vlerësim, do të fillohet me realizimin e punëve konkrete për çka edhe është nënshkruar Memorandum Bashkëfinancimi tre-palësh me KFW dhe BE. Ndërkaq, Komuna e Pejës është zotuar t'i ndajë 3 milionë € për zbatimin e këtij aktiviteti.

Sa i përket **studimit të fizibilitetit për projektin e transfer stacionit në Ferizaj**, ky aktivitet tani do të kombinohet me projektin e deponisë, i financuar nga KfW dhe i përshkruar më sipër.

Ndërkaq, në lidhje me aktivitetet që kanë të bëjnë me **ndërtimin e transfer stacionit në Malishevë**, MMPHI nuk ka marrë asnjë informacion për arsyet e vonesës së këtyre aktiviteteve.

**Përmirësimi dhe zgjerimi i deponisë ekzistuese në Dragash**. Deri më tani është identifikuar lokacioni për përmirësimin dhe zgjerimin e deponisë si dhe me mbështetjen e JICA-së janë siguruar disa nga mjetet e nevojshme teknike për kryerjen e veprimeve në deponi, si dhe janë kryer veprime të tjera në përmirësimin e deponisë.

**Indikatori përkatës për këtë objektiv specifik**:

- *Përqindja e gjithsej mbeturinave të ngurta komunale të prodhuara që menaxhohen në qendra të kontrolluara – 60% deri në vitin 2023*. Edhe pse AMMK-ja raportoi në vitin 2020 se 446.332 tonë mbeturina komunale janë deponuar në deponitë sanitare, që përbën 94% të mbeturinave komunale të prodhuara, sasi e konsiderueshme e mbeturinave u deponuan në deponinë e KMDK-së. Duke marrë parasysh gjendjen aktuale, zbatimi i projektit KfW-së jep besim se caku përfundimtar (100% e mbeturinave komunale të menaxhohen në qendra të kontrolluara) do të arrihet deri në vitin 2030.

## 2.1.3. Objektivi specifik 1.3: Zhvillimi i sistemeve për kontrollimin dhe menaxhimin e mbeturinave të tjera

Institucionet publike janë mbështetur nga IFN dhe partnerë të tjerë bashkëpunimi për zbatimin e këtij objektivi specifik. Zhvillimi i **Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbeturinave nga Ndërtimi dhe Rrënimi** është hartuar drafti nga BERZH-i dhe pritet ti dergohet MMPHI per miratim. Nga ana tjetër, GIZ-i ka ofruar mbështetje për MMPHI-në dhe Ministrinë e Shëndetësisë në **zhvillimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbeturinave Spitalore (MMS)**.

Figura 6 tregon progresin e përgjithshëm të zbatimit të këtij objektivi specifik.




**Figura 6. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të objektivit specifik 1.3**

Tabela 5 përshkruan pesë aktivitetet e planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022.

**Tabela 5. Statusi i aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, OSp 1.3**

| Nr. | Aktiviteti | Përgjegjës | Statusi i progresit | Buxheti i shpenzuar |
|---|---|---|---|---|
| 1.3.1 | Plani i hollësishëm i menaxhimit të MNRr-ve | MMPHI | plotësisht i zbatuar | 40,000 |
| 1.3.2 | Rishikimi i Udhëzimit Administrativ për menaxhimin e MNRr-ve | MMPHI | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 1.3.3 | Ndërtimi i qendrave për trajtimin e MNRr-ve në komunat e Kosovës | KOM | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 1.3.8 | Plani i hollësishëm i menaxhimit të mbeturinave medicinale spitalore | MSH | plotësisht i zbatuar | 22,500 |
| 1.3.9 | Plani i hollësishëm për menaxhimin e mbeturinave të kafshëve dhe nënprodukteve të kafshëve | MBPZHR (AUV) | nuk ka filluar zbatimi | 0 |

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave nga Ndërtimi dhe Rrënimi (PMMNRr) është financuar nga BERZH dhe përfundon në fund të muajit mars 2023.

Në lidhje me ndërtimin e qendrave për trajtimin e MNRr-ve në komunat e Kosovës, vetëm komuna e Prizrenit ka raportuar se ka filluar me plotësimin e formularit për grante për KIBP që sipas saj do të përfundojë brenda tremujorit të parë të vitit 2023.

Ndërkaq, Komuna e Pejës ka raportuar se aktualisht është në proces të hartimit të sistemit për Menaxhimin e Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënimit në Kosovë përmes konsulencës, duke u fokusuar në objektivat e menaxhimit të MNRr-ve, infrastrukturën dhe vendndodhjen, si dhe elementet përkatëse institucionale dhe financiare.

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me MMPHI-në dhe mbështetjen e GIZ-it e ka hartuar draft Planin e hollësishëm të menaxhimit të mbeturinave medicinale/spitalore në vitin 2022 si dhe i ka realizuar konsultimet e nevojshme me palët e përfshira në proces.

Sa i përket Planit të hollësishëm për menaxhimin e mbeturinave të kafshëve dhe nënprodukteve të kafshëve, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës ka raportuar se gjatë vitit 2022 kanë siguruar mbështetje financiare për zhvillimin e studimit të fizibilitetit i cili do të jap një pasqyrë të qartë të mënyrës së funksionalizimit të Fabrikës së Riciklimit.

**Indikatori përkatës për këtë objektiv specifik**:

- *Një sistem për menaxhimin e ndarë të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit do të krijohet deri në vitin 2024.* Nuk parashikohen pengesa të mëdha në arritjen e këtij indikatori, pasi aktiviteti themelor është drejt përfundimit.
- *Planet e menaxhimit të mbeturinave (PMM) përpunohen, miratohen dhe publikohen për mbeturinat e kafshëve dhe nënprodukteve të kafshëve dhe mbeturinat spitalore (Plani i Menaxhimit të Mbeturinave të Spitalore) publikohet deri në vitin 2023; PMM të Nënprodukteve të Kafshëve publikohet deri në vitin 2024; dhe PMM nga Ndërtimi dhe Rrënimi publikohet deri në vitin 2023).* Vetëm PMM të Nënprodukteve të Kafshëve nuk ka filluar ende. Afati i

përcaktuar për vitin 2024 lejon që ky aktivitet të fillojë dhe të përfundojë sipas planit. MMPHI-ja do të monitorojë nga afër zhvillimet e këtij aktiviteti.

## 2.2. Progresi kundrejt Objektivit Strategjik 2: Profesionalizimi i sektorit të menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave.

Shëndeti publik dhe mbrojtja mjedisore mund të sigurohet vetëm nëse industria e menaxhimit të mbeturinave i përmbahet standardeve profesionale. Plani i Veprimit përfshin **7 aktivitete** për të mbështetur profesionalizimin e sektorit të menaxhimit të mbeturinave. Figura 7 tregon progresin e përgjithshëm për periudhën aktuale të raportimit:




**Figure 7. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të Objektivit Strategjik 2**

Objektivi strategjik do të realizohet me ndihmën e tri objektivave specifike si në vijim:

- Vazhdimi i ndërtimit të kapaciteteve profesionale në sektorin publik dhe privat
- Krijimi i një kodi industrial në statistikat kombëtare për sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave
- Nxitja e kërkimit dhe zhvillimit në Universitete

### 2.2.1. Objektivi Specifik 2.1: Vazhdimi i ndërtimit të kapaciteteve profesionale në sektorin publik dhe privat

Ky objektiv specifik përbëhet prej dy aktiviteteve kryesore – **Mbështetja e MMPHI në monitorimin e SKMMN, në rishikimin/përditësimin e Planit të Veprimit dhe shtytja e projekteve drejt zbatimit,** si dhe **Masat e dedikuara kualifikuese për ekspertizën e MM.** Të dy aktivitetet mbështeten nga BE-ja dhe GDC (BGjZh), dhe zbatohen në vazhdimësi.

Figura 8 tregon ecurinë e përgjithshme të zbatimit të këtij objektivi specifik.




**Figure 8. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të Objektivit Specifik 2.1**

Tabela 6 e mëposhtme paraqet dy aktivitetet e planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, si dhe statusin e tyre.

**Tabela 6. Statusi i aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, OSp. 2.1**

| Nr. | Aktiviteti | Përgjegjës | Statusi i progresit | Buxheti i shpenzuar |
|---|---|---|---|---|
| 2.1.1 | Mbështetja e MMPHI në monitorimin e SKMMN, në rishikimin / përditësimin e Planit të Veprimit dhe shtytjen e projekteve drejt zbatimit | BE/GDC (BGjZh) | pjesërisht i zbatuar | 144,900 |
| 2.1.2 | Masat e dedikuara kualifikuese për ekspertizën e MM | BE/GDC (BGjZh) | pjesërisht i zbatuar | 227,000 |

Mbështetje gjithëpërfshirëse është ofruar nga BE/GIZ në përpjekjet e vazhdueshme për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale në sektorin publik dhe privat. Shtojca 1 ofron një listë të fushave ku është ofruar mbështetje e vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve, si dhe palët e interesuara të angazhuara në aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve.

Për më tepër, BE/GIZ ka mbështetur institucionet për krijimin e strukturës (grupi punues ndërministror) përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë në përputhje me Udhëzimin Administrativ për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit. Përveç kësaj, BE/GIZ i ka ofruar mbështetje MMPHI-së me një instrument të monitorimit, i cili do të lehtësojë punën e grupit punues ndërministror. Për këtë qëllim janë përcaktuar personat kontaktues përgjegjës për raportimin dhe monitorimin e zbatimit të planit të veprimit në ministritë e linjës, në komunat përkatëse dhe institucionet e tjera përgjegjëse të parapara në planin e veprimit. GIZ ka mbështetur dhe lehtësuar mbajtjen e dy tryezave të rrumbullakëta të diskutimit me anëtarët e grupit punues. Grupi punues ndërministror ka mbledhur të gjitha të dhënat relevante për të përcaktuar statusin aktual të zbatimit të secilit aktivitet të planit të veprimit, në mënyrë që të mundësohet rishikimi i planit të veprimit dhe rishikimi i synimeve të riciklimit.

**Indikatori përkatës për këtë objektiv specifik:**

- *Krijimi i një programi gjithëpërfshirës të zhvillimit të kapaciteteve, me fokus në përmirësimin e kapaciteteve të personelit që punon në qeverinë qendrore, në kompanitë publike dhe në komuna.*

## 2.2.2. Objektivi Specifik 2.2: Krijimi i një kodi industrial për sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave në statistikat kombëtare

Figura 9 tregon ecurinë e përgjithshme të zbatimit të këtij objektivi specifik.




**Figura 9. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të Objektivit Specifik 2.2**

Tabela 7 përshkruan tre aktivitetet e planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022.

**Tabela 7. Statusi i aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, OSp. 2.2**

| Nr. | Aktiviteti | Përgjegjës | Statusi i progresit | Buxheti i shpenzuar |
|---|---|---|---|---|
| 2.2.1 | Mundësimi dhe raportimi i vendeve të punës dhe bizneseve të lidhura me mbeturinat në statistikat kombëtare | INST (Agjencia e Statistikave të Kosovës) | pjesërisht i zbatuar | 6,000 |
| 2.2.2 | Mbështetja e krijimit të një sistemi të trajnimit dhe akreditimit | INST (MPB) | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 2.2.3 | Mbështetja për formalizimin ose njohjen e akterëve joformalë në MMN | BE/GDC (BGjZh) | pjesërisht i zbatuar | 50,260 |

Përkitazi me **Mbështetjen për formalizimin ose njohjen e akterëve joformalë në MMN** është identifikuar një rajon pilot në Fushë Kosovë. 200 akterë jo-formalë dhe familjet e tyre janë intervistuar dhe është bërë një hartëzim social i kushteve të tyre të jetesës. Një vlerësim/anketë është bërë për të hedhur dritë edhe mbi fraksionin e mbeturinave të mbledhura nga akterët jo-formalë dhe sasinë e rikuperuar dhe një raport mbi këtë do të publikohet deri në mars 2023. Këto të dhëna nuk ekzistojnë në asnjë hulumtim të mëparshëm dhe mund të shihet si diçka inovative. Të dhënat nga ky veprim do të shërbejnë për të integruar akterët jo-formalë në hartimin e politikave vendore dhe në planet e menaxhimit të integruar ndërkomunal të mbeturinave si dhe në plane dhe kuadre të politikave të tjera.

Për aktivitetin e parë, MMPHI ka kërkuar të dhëna lidhur me statusin e zbatimit të aktivitetit 2.2.1 dhe e njëjta ka konfirmuar se zbatimi i veprimit do të fillojë në mars të vitit 2023 pasi ASK-ja ka hasur në vështirësi në përcaktimin e metodologjisë së kodifikimit dhe raportimit të duhur profesional të menaxhimit të mbeturinave.

**Indikatori përkatës për këtë objektiv specifik:**

- *Përfshirja e industrisë së menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave në statistikat kombëtare deri në vitin 2023.*
- *Krijimi i një trupi përfaqësues të industrisë së menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave deri në vitin 2023.*

Ndonëse kanë mbetur vetëm 11 muaj deri në afatin për arritjen e këtyre dy indikatorëve, ekziston rreziku për tejkalimin e afateve. Për të adresuar këtë sfidë, MMPHI synon të iniciojë diskutime me institucionet përkatëse përgjegjëse dhe të lehtësojë fillimin e procesit të zbatimit.

### 2.2.3. Objektivi Specifik 2.3: Promovimi i hulumtimit dhe zhvillimit në universitete

Zbatimi i këtij objektivi specifik ende nuk ka filluar. Dy aktivitetet e parashikuara në SMIMK deri në vitin 2023 për të mbështetur zbatimin e këtij objektivi specifik janë: **zhvillimi ose përshtatja e kurikulave të përshtatshme të arsimit të lartë për MMN** dhe **partneriteti me Universitetet Evropiane për shkëmbimin e njohurive dhe kërkimin.**

Figura 10 tregon ecurinë e përgjithshme të zbatimit të këtij objektivi specifik.




**Figura 10. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të Objektivit Specifik 2.3**

Këto aktivitete janë paraqitur në tabelën 8. Asnjëri prej tyre nuk ka filluar ende.

**Tabela 8. Statusi i aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, SpO 2.3**

| Nr. | Aktiviteti | Përgjegjës | Statusi i progresit | Buxheti i shpenzuar |
|---|---|---|---|---|
| 2.3.1 | Zhvillimi ose përshtatja e kurrikulave të përshtatshme të arsimit të lartë për MMN | INST | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 2.3.2 | Lidhja e partneritetit me universitetet evropiane për shkëmbim të njohurive dhe hulumtim | INST | nuk ka filluar zbatimi | 0 |

Institucioni përgjegjës për të dy aktivitetet është Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).

Këto aktivitete duhet të përfundojnë deri në fund të vitit 2023.

MMPHI do të jetë në kontakt me MASHT-in për të mësuar nëse partneriteti me ndonjë Universitet evropian është eksploruar dhe cili është statusi i këtij aktiviteti.

**Indikatori përkatës për këtë objektiv specifik**:

- *Vendosja në Universitet e një Kursi/moduli të MIMN deri në vitin 2025.* Megjithëse aktiviteti themelor duhet të kishte filluar tashmë, afati për arritjen e këtij indikatori jep besimin se indikatori do të arrihet.

## 2.3. Progresi kundrejt Objektivit Strategjik 3: Forcimi i rregullimit dhe kontrollit në sektorin e menaxhimit të mbeturinave duke i plotësuar boshllëqet dhe duke qartësuar mekanizmat e zbatimit.

SMIMK përcakton se dhënia e lejeve duhet të zgjerohet për të gjitha mbeturinat dhe operatorët e menaxhimit të mbeturinave dhe objektet, e po ashtu edhe kërkesat rregullatore dhe mekanizmat e zbatimit duhet të forcohen më tej. Plani i veprimit përfshin **8 aktivitete** për të mbështetur zbatimin e këtij objektivi strategjik. Figura 11 në vijim tregon progresin e përgjithshëm për periudhën aktuale të raportimit:




**Figura 11. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të Objektivit Strategjik 3**

Objektivi strategjik do të realizohet me ndihmën e tri objektivave specifike të mëposhtme:

- Krijimi i një sistemi informacioni gjithëpërfshirës dhe funksional për menaxhimin e mbeturinave.
- Zgjerimi i sistemit të dhënies së lejeve për menaxhimin e mbeturinave për të mbuluar të gjitha mbeturinat, operatorët dhe objektet e menaxhimit të mbeturinave.
- Forcimi i mekanizmave që përfshijnë komunat dhe inspektoratet.

## 2.3.1. Objektivi Specifik 3.1: Krijimi i një sistemi informativ gjithëpërfshirës dhe funksional për menaxhimin e mbeturinave

Zbatimi i duhur i këtij objektivi specifik kërkon rritje të kapaciteteve në të gjitha nivelet për arritjen e synimeve dhe afatin kohor të parashikuar për fazat kryesore në menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe ekonominë qarkore në Kosovë, siç është planifikuar nga SMIMK. Përparim i konsiderueshëm është shënuar në raportimin e mbeturinave dhe miratimin e planeve të menaxhimit të mbeturinave komunale. Figura 12 tregon ecurinë e përgjithshme të zbatimit të këtij objektivi specifik.




**Figura 12. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të Objektivit Specifik 3.1**

Tabela 9 paraqet tre aktivitetet e planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, si dhe statusin e tyre.

**Tabela 9. Statusi i aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, OSp. 3.1**

| Nr. | Aktiviteti | Përgjegjës | Statusi i progresit | Buxheti i shpenzuar |
|---|---|---|---|---|
| 3.1.1 | Krijimi i SIMM | AMMK | plotësisht i zbatuar | |
| 3.1.2 | Ofrimi i trajnimit dhe mbikëqyrjes për operatorët e mbeturinave me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe disponueshmërisë së të dhënave | AMMK | plotësisht i zbatuar | 51,250 |
| 3.1.3 | Rritja e funksioneve institucionale në Monitorim dhe Raportim (AMMK) | BE/GIZ | Plotësisht i zbatuar | 95,000 |

Lidhur me **Krijimin e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Mbeturinave (SIMM)** për AMMK-në, në fillim të vitit 2022 një aplikacion  për menaxhimin e mbeturinave i bazuar në internet është zhvilluar dhe finalizimi i këtj zhvillimi u arrit në dhjetor 2022. Në shkurt 2023 pritet të mbahen trajnime në lidhje me këtë aplikacion, ndërsa i qasshëm për publikun ai do të jetë vetëm në fund të vitit 2023 duke marrë parasysh kohën që merr procesi në lidhje me dizajnimin dhe faktorë të tjerë teknikë.

Nevojat për trajnim të operatorëve të mbeturinave janë identifikuar në vitin 2018 dhe janë zhvilluar **trajnime të operatorëve të mbeturinave për të përmirësuar cilësinë dhe disponueshmërinë e të dhënave**. Tashmë është zbatuar po ashtu edhe **Rritja e funksioneve institucionale në aktivitetet e Monitorimit dhe Raportimit n**ëpërmjet mbështetjes nga BE dhe GIZ.

**Indikatori përkatës për këtë objektiv specifik**:

- *Krijimi i një sistemi informativ gjithëpërfshirës dhe funksional për menaxhimin e mbeturinave (deri në vitin 2021) dhe të qasshëm për publikun (deri në vitin 2023)*. SIMM nuk ka mundur të përfundohet deri në fund të vitit 2021, dhe aktualisht është në zhvillim e sipër, si dhe parashihet të hyjë në funksion deri në fund të vitit 2022. Sistemi i lartpërmendur do të jetë gjithashtu i qasshëm për publikun në fund të vitit 2023, ashtu siç ishte planifikuar.

## 2.3.2. Objektivi Specifik 3.2: Zgjerimi i sistemit të dhënies së licencave dhe lejeve për menaxhimin e mbeturinave për t'i mbuluar të gjitha mbeturinat, operatorët dhe qendrat e menaxhimit të mbeturinave

Zbatimi i këtij objektivi specifik ende nuk ka filluar. Arsyet për këtë janë të shumta dhe shpjegohen më poshtë. Figura 13 tregon ecurinë e përgjithshme të zbatimit të këtij objektivi specifik.




**Figura 13. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të Objektivit Specifik 3.2**

Tabela 10 paraqet katër aktivitetet e planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, si dhe statusin e tyre.

**Tabela 10. Statusi i aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, OSp. 3.2**

| Nr. | Aktiviteti | Përgjegjës | Statusi i progresit | Buxheti i shpenzuar |
|---|---|---|---|---|
| 3.2.1 | Hartimi i përshkrimeve të vendeve të punës, kërkesave për personel dhe vlerësimi i nevojave për trajnim për ministritë përkatëse dhe AMMK-në | MMPHI | pjesërisht i zbatuar | 0 |
| 3.2.2 | Zhvillimi i një programi kualifikimi bazuar në vlerësimin e nevojave për tërë stafin e AMMK-së | AMMK | pjesërisht i zbatuar | 0 |
| 3.2.3 | Krijimi i SIE, përmirësimi i bazës së të dhënave të të gjithë gjeneruesve të mbeturinave, duke përfshirë instalimet e mëdha të listuara sipas në leje sipas Direktivës 2010/75/EU (Shtojca I) | AMMK | pjesërisht i zbatuar | 0 |
| 3.2.4 | Plani për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme | MMPHI | nuk ka filluar zbatimi | 0 |

Sa i përket **hartimit të përshkrimeve të vendeve të punës, kërkesave për personel dhe vlerësimit të nevojave për trajnim për ministritë përkatëse dhe aktivitetin e AMMK-së**. MMPHI-ja gjatë vitit 2022 ka filluar me hartimin e draft Rregullores për Ri-organizmin dhe sistematizimin e vendeve të punës të MMPHI e cila draft Rregullore ende nuk është miratuar. Zhvillimi i kërkesave për personel dhe nevoja për trajnim varet nga ri-organizimi i ministrisë i cili do të realizohet përmes Rregullores së re.

Sa i përket **programit të kualifikimit bazuar në vlerësimin e nevojave për tërë stafin e AMMK-së,** vlerësimi i nevojave është bërë për krijimin e Kadastrës së mbeturinave dhe kimikateve të rrezikshme. Programi i kualifikimit do të pasojë pas përfundimit të vlerësimit të nevojave.

**Përmirësimi i bazës së të dhënave** për gjeneruesit e mbeturinave është bërë, por ende nuk **përfshin instalimet e mëdha të listuara në leje sipas Direktivës 2010/75/EU.** Aktualisht, baza e të dhënave është e disponueshme vetëm për komunat, operatorët e mbeturinave dhe transportuesit.

**Plani për Menaxhimin e Mbeturinave të Rrezikshme** pritet të har tohet deri në fund të vitit 2023. Një plan i tillë duhet të përfshihet në aktivitetet përgatitore të projektit të përgjithshëm për ndërtimin e objektit për magazinimin e mbeturinave të rrezikshme. Ndërkohë, një udhërrefyes dpër menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme është duke u zhvilluar nga BE dhe MMPHI/ dhe është prezantuar në javën e parë të muajit Shkurt 2023.

Asistenca teknike e parashikuar për **mbikëqyrjen e ndërtimit të objektit të menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme** mund të fillojë vetëm pas nënshkrimit të kontratës së punimeve përkatëse.

**Indikatorët përkatës për këtë objektiv specifik**:

- *Plani i menaxhimit të mbeturinave industriale (të rrezikshme dhe jo të rrezikshme) në fuqi (deri në vitin 2022).* Aktiviteti lidhur me këtë indikator është planifikuar dhe pritet të zbatohet në vitin 2023.

## 2.3.3. Objektivi Specifik 3.3: Forcimi i mekanizmave zbatues, përfshirë komunat dhe inspektoratet

Zbatimi i këtij objektivi specifik ende nuk ka filluar. Aktiviteti i planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës përkatëse raportuese në mbështetje të zbatimit të këtij objektivi specifik është: rishikimi i mekanizmave të zbatimit nga AMMK në bashkëpunim të ngushtë me komunat.

Në këtë kontekst, MMPHI ka përgatitur ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në shtator të vitit 2022 ku gjobat dhe sanksionet e ndryshme janë përcaktuar në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbeturina. I njejti është harmonizuar me Ligjin për Kundërvajtje.




**Figura 14. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të Objektivit Specifik 3.3**

**Tabela 11. Statusi i aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, OSp. 3.3**

| Nr. | Aktiviteti | Përgjegjës | Statusi i progresit | Buxheti i shpenzuar |
|---|---|---|---|---|
| 3.3.1 | Rishikimi i mekanizmave të zbatimit nga AMMK-ja, në bashkëpunim të ngushtë me komunat | AMMK | nuk ka filluar zbatimi | 0 |

**Indikatori përkatës për këtë objektiv specifik**:

*Përmirësimi i pajtueshmërisë së gjeneruesve dhe operatorëve të mbeturinave me kërkesat ligjore.*

## 2.4. Progresi kundrejt Objektivit Strategjik 4: Promovimi i vlerave dhe praktikave të një ekonomie qarkore.

Një ndryshim kulturor i qëndrimeve dhe sjelljeve është i nevojshëm për të mbështetur tranzicionin drejt efikasitetit të resurseve dhe ekonomisë qarkore, siç identifikohet në SMIMK. Në total, Plani i Veprimit përfshin 16 **aktivitete** për të mbështetur zbatimin e këtij objektivi strategjik. Figura 14 tregon ecurinë e përgjithshme për periudhën aktuale të raportimit:




**Figura 14. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të Objektivit Strategjik 4**

Objektivi strategjik do të realizohet me ndihmën e tri objektivave specifike të mëposhtme:

- Ngritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë dhe përfitimet e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave
- Stimulimi i inovacioneve për parandalimin e mbeturinave
- Krijimi i sistemeve të ripërdorimit dhe riciklimit, bazuar në konceptin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit

### 2.4.1. Objektivi specifik 4.1: Ngritja e vetëdijes për rëndësinë dhe dobitë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave

Rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirja e publikut është thelbësore për funksionimin e përgjithshëm të shërbimeve të menaxhimit të integruar të mbeturinave në vend. Kjo bëhet veçanërisht e rëndësishme sa i përket vlerave dhe praktikave të një ekonomie qarkore, që janë përcaktuar në të gjitha shtetet anëtare të BE-së.

MMPHI ka organizuar Javën e Qëndrueshme në Kosovë në maj të vitit 2022, me ç'rast janë trajtuar disa tema të ekonomisë qarkore për të rritur ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave.

Në bashkëpunim të ngushtë me institucione të ndryshme të nivelit qendror dhe lokal janë organizuar fushata dhe aktivitete shtesë.

Figura 15 tregon ecurinë e përgjithshme të zbatimit të këtij objektivi specifik.




**Figura 15. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të Objektivit Specifik 4.1**

Tabela 12 paraqet pesë aktivitetet e planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, si dhe statusin e tyre.

**Tabela 12. Statusi i aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, OSp. 4.1**

| Nr. | Aktiviteti | Përgjegjës | Statusi i progresit | Buxheti i shpenzuar |
|---|---|---|---|---|
| 4.1.1 | Komunikimi i Strategjisë tek palët e interesuara dhe publiku | MMPHI | plotësisht i zbatuar | 0 |
| 4.1.2 | Hartimi i një programi të përgjithshëm të ndryshimit të sjelljes me fushat kryesore të ndërhyrjes dhe grupet e synuara | MMPHI | pjesërisht i zbatuar | 0 |
| 4.1.3 | Zbatimi i fushatës 2020-2022, duke përfshirë publikimin e rezultateve | MMPHI | plotësisht i zbatuar | 142,500 |
| 4.1.4 | Ndryshimi i kurikulave të shkollave për fazat kryesore me njohuritë për MIMN dhe qëndrimin mjedisor | INST | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 4.1.6 | Fushata ndërgjegjësuese në komunat e Pejës, Istogut, Klinës, Deçanit dhe Junikut lidhur me deponinë e re | KOM | pjesërisht i zbatuar | 3,300 |

**Hartimi i një programi të përgjithshëm të ndryshimit të sjelljes me fushat kryesore të ndërhyrjes dhe grupet e synuara** është ndërprerë dhe shtyrë për shkak të zhvendosjes së prioriteteve, pas situatës së krijuar nga pandemia, si dhe mungesës së burimeve brenda DMK. Për t'iu përmbajtur afateve të përcaktuara, DMK në kuadër të MMPHI synon të fillojë me zbatimin e këtij aktiviteti deri në fund të vitit 2022. Në këtë drejtim, MMPHI para dhe pas miratimit të Udhëzimit Administrativ për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit, do të filloj me fushata ndërgjegjësimi për reduktimin e përdorimit të qeseve të plastikës në përputhje me masat e propozuara në Udhëzimin Administrativ.

Për sa i përket aktivitetit 4.1.3, MMPHI ka zhvilluar fushata vetëdijësuese në kuadër të kalendarit të festave mjedisore me çrast përfitues kanë qenë qytetarë, nxënës dhe shoqëria në përgjithësi.

**Indikatori përkatës për këtë objektiv specifik**:

- *Vlerësimi dhe publikimi i matjes së ndikimit të fushatave në rritjen e ndërgjegjësimit deri në 2024, 2027 dhe 2030.* Pasi të zhvillohet koncepti i programit të përgjithshëm të ndryshimit të sjelljes, MMPHI do të iniciojë fushata të synuara të ndërgjegjësimit. Pas secilës fushatë të tillë, ndikimet do të vlerësohen dhe publikohen në faqen e internetit të Ministrisë.

## 2.4.2. Objektivi specifik 4.2 Stimulimi i inovacioneve në parandalimin e mbeturinave

BE-ja po i kushton vëmendje të madhe parandalimit të mbeturinave. Kjo vjen si përgjigje ndaj pakos së ekonomisë qarkore të BE-së, të miratuar fillimisht në vitin 2015, dhe të përditësuar me Planin e Veprimit drejt Ekonomisë Qarkore në vitin 2020. Institucionet e Kosovës do të kërkojnë fonde si grante nga partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit për inovacion. Këto grante inovacioni do të vihen në dispozicion në bazë konkurruese për projektet që promovojnë parandalimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave, me fokus të veçantë në reduktimin e mbeturinave ushqimore dhe gjetjen e alternativave ndaj ambalazheve dhe produkteve plastike. Figura 16 në vijim tregon ecurinë e përgjithshme të zbatimit të këtij objektivi specifik.




**Figura 16. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të Objektivit Specifik 4.2**

Tabela 13 paraqet tre aktivitetet e planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, si dhe statusin e tyre.

**Tabela 13. Statusi i aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, OSp. 4.2**

| Nr. | Aktiviteti | Përgjegjës | Statusi i progresit | Buxheti i shpenzuar |
|---|---|---|---|---|
| 4.2.1 | Krijimi i bazës së nevojshme ligjore kombëtare për zhvillim - përkthimi i kërkesave të nevojshme të etiketimit në rregulloret kombëtare | MMPHI | pjesërisht i zbatuar | 0 |
| 4.2.2 | Zhvillimi i skemës së granteve të inovacionit me kriteret e pranueshmërisë, dizajnin e konkurrencës dhe burimet e financimit | INST | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 4.2.3 | Shpërndarja nëpër amvisëri e pajisjeve të kompostimit shtëpiak | KOM | plotësisht i zbatuar | 158,170 |

Si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të vendit për të transpozuar *Acquis* të BE-së për Mjedisin në legjislacionin kombëtar, MMPHI synon të **krijojë kornizën e nevojshme ligjore kombëtare në lidhje me kërkesat e nevojshme të etiketimit, të përcaktuara në *Acquis* të BE-së.** Ky aktivitet duhet të përfundojë deri në fund të vitit 2023, siç ishte planifikuar fillimisht. Për këtë qëllim, MMPHI ka hartuar ndryshimet për Ligjin për Mbeturinat, me qëllim të harmonizimit të mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me *Acquis* të BE-së. Gjithashtu, projektligji krijon bazën ligjore për Qeverinë, që të përcaktojë më tej kriteret dhe kërkesat, për të prezantuar me sukses Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesit dhe Sistemin e Rimbursimit të Depozitave për tu adresuar në aktet nënligjore për ambalazhin dhe mbeturinat e ambalazhit si dhe aktet tjera përkatëse nënligjore.

Zbatimi i skemës së granteve të inovacionit me kriteret e pranueshmërisë, dizajnimin e konkurrencës dhe burimet e financimit nuk ka filluar ende. Institucioni përgjegjës është Ministria e Ekonomisë. Aktiviteti ishte planifikuar të fillonte në shkurt 2022, dhe të përfundonte në fund të vitit 2023. MMPHI do të komunikojë me ME për hapat e ardhshëm për aktivitetet e tilla

parandaluese të mbeturinave dhe nuk duhet të ketë pengesa në përfundimin në kohë të këtij aktiviteti të rëndësishëm.

Për sa i përket aktivitetit 4.2.3, gjatë vitit 2022 BE/GIZ kanë shpërndarë gjithsej 1858 pajisje të kompostimit shtëpiak nëpër komuna të ndryshme të Kosovës, përderisa caku ishte vetëm 1500 pajisje kompostimi. Gjithashtu, me mbështetjen e BE/GIZ - komuna e Prishtinës gjatë muajit korrik të vitit 2022 e ka funksionalizuar Qendrën për Kompostim e cila do të jetë në funksion të përmirësimit të gjendjes ekzistuese. Shpërndarja e numrit të lartcekur të pajisjeve të kompostimit shtëpiak dhe vënia në operim e Qendrës për Kompostim në Prishtinë përveq që kanë kontribuar në reduktimin e mbeturinave ato kanë ndikuar edhe në reduktimin e emetimit të gazeve serrë në vend për rreth 1,378 ton të $CO_2$ (dioksid karboni) përgjatë vitit 2022, duke ndikuar kështu njëherit edhe në përmirësimin e kualitetit të ajrit, ruajtjen e shëndetit publik dhe ngadalësimin e procesit të ndryshimeve klimatike.

**Indikatori përkatës për këtë objektiv specifik:**

*Zgjidhjet e zhvilluara në nivel lokal për parandalimin e mbeturinave po zbatohen me mbështetjen e një sistemi Granti i Inovacionit (me raundin e parë të aplikimit për grante për zgjidhje inovative të përfundojë në vitin 2024, duke mbështetur të paktën 10 projekte). Siç është përmendur tashmë, burimet e financimit janë të disponueshme përmes iniciativave të ndryshme të BE-së dhe KE-së dhe nuk supozohen rreziqe në arritjen në kohë të këtij indikatori.*

## 2.4.3. Objektivi specifik 4.3: Krijimi i sistemeve të ripërdorimit dhe riciklimit bazuar në konceptin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit

Për arritjen e këtij objektivi specifik, SMIMK parasheh përcaktimin e skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (PZP) për kategoritë e produkteve – ambalazhet, MPEE, bateritë, automjetet e vjetruara - deri në vitin 2024. Deri më tani, nuk ka skema zyrtare të veçanta të grumbullimit ose të PZP të vendosura për asnjërën prej këtyre rrymave të mbeturinave. Figura 17 paraqet ecurinë e përgjithshme të zbatimit të këtij objektivi specifik.




**Figura 17. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të Objektivit Specifik 4.3**

Tabela 14 e mëposhtme paraqet tetë aktivitetet e planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, si dhe statusin e tyre.

**Tabela 14. Statusi i aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese Qershor 2021 – Dhjetor 2022, OSp 4.3**

| Nr. | Aktiviteti | Përgjegjës | Statusi i progresit | Buxheti i shpenzuar |
|---|---|---|---|---|
| 4.3.1 | Zhvillimi dhe zbatimi i rregulloreve dhe skemave të nevojshme për mbeturinat e ambalazhimit të bazuara në PZP | MMPHI | pjesërisht i zbatuar | 7.600 |
| 4.3.1a | Sistemet PZP (SKR) në zhvillim e sipër | BE/GDC (BGjZh) | pjesërisht i zbatuar | 103,124 |
| 4.3.2 | Zhvillimi dhe zbatimi i rregulloreve dhe skemave të nevojshme për MPEE, bateritë, AV-të, mbetjet e vajrave, gomat bazuar në PZP | MMPHI | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 4.3.3 | Studimi i fizibilitetit dhe projektimi për Qendrën e ndarjes, klasifikimit dhe riciklimit si dhe qendrën e kompostimit në Prizren | KOM | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 4.3.6 | Studimi i fizibilitetit dhe dizajni për MRF në Pejë | KOM | pjesërisht i zbatuar | 0 |
| 4.3.9 | Studimi i fizibilitetit dhe dizajni për ngritjen e Qendrën e ndarjes, klasifikimit dhe riciklimit në Prishtinë | KOM | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 4.3.12 | Studimi i fizibilitetit dhe dizajni për ngritjen e QRM në Mitrovicë | KOM | nuk ka filluar zbatimi | 0 |
| 4.3.28 | Promovimi i ndarjes në burim dhe zinxhirëve të vlerës së riciklimit | BE/GDC (BGjZh) | pjesërisht i zbatuar | 143,770 |

MMPHI-ja gjatë periudhës raportuese ka punuar intenzivisht në ndryshimin e Ligjit për mbeturina. Me miratimin e Ligjit Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina nga Kuvendi i Kosovës, është krijuar baza ligjore për krijimin e Sistemit të Rimbursimit të Depozitës si dhe është krijuar baza ligjore për krijimin e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit. Në këtë drejtim, ligji i ri po ashtu ka përcaktuar dispozitat kundërvajtëse i cili është harmonizuar me Ligjin për Kundërvajtje. Pra, ligji i ri i miratuar **mundëson miratimin e rregulloreve dhe skemave të nevojshme për mbeturinat e ambalazhit të bazuar në PZP.** Puna planifikuese është kryer gjatë vitit 2021 për zbatimin e skemës së rimbursimit të depozitave (SRD) për ambalazhet e pijeve me mbështetjen e BE/GDC(BGjZh) të ofruar përmes Asistencës Teknike të jashtme nga GIZ. Janë bërë analiza lidhur me kornizën ligjore dhe institucionale të SRD, dhe për këtë qëllim MMPHI e ka hartuar Projekt Udhëzimin Administrativ për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit për të cilin janë realizuar konsultimet paraprake dhe konsultimet me publikun. Vonesat në SRD janë kryesisht për shkak të situatës me pandeminë dhe ndryshimit të afateve. Më 30 Qershor 2022, janë shpenzuar EUR 39,640.72 nga shuma e përgjithshme prej EUR 91,078.00, të ndara për studimin përgatitor për SRD (duke mos mbuluar zbatimin e veprimeve përkatëse). Zbatimi i skemës së tillë të SRD është planifikuar të përfundojë gjatë periudhës 2022-2024.

Për **kategoritë e tjera të produkteve**, GIZ do të mbështesë përpjekjet e Qeverisë duke ofruar asistencë teknike për krijimin e skemave PZP për MPEE, bateritë, automjetet e vjetruara deri në fund të vitit 2024. Gjatë vitit 2022 është përzgjedhur kompania e cila do të ofrojë konsulencë në analizimin e gjendjes ekzistuese, si dhe do të përgadisë planin e studimit dhe ofroj mbështetje në hartimin e kornizës ligjore për krijimin e këtyre skemave.

Sa i përket **Promovimit të Ndarjes Në burim dhe zinxhirëve të vlerës së riciklimit** - studimi fillestar dëshmoi se masat e veçanta të Ndarjes në Burim ndërlikojnë dhe mund të dëmtojnë

përpjekjet që do të ndërmerren në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal për planet/sistemin e integruar të menaxhimit të mbeturinave të ngurta.

Si përfundim, mund të thuhet se nuk ka rrezik që **indikatori për përmbushjen e këtij objektivi specifik të mos arrihet deri në vitin 2024.** Në terma afatmesëm, SMIMK parasheh investime në impiantet e kompostimit në Prizren, Pejë dhe Gjilan dhe në objektet e riciklimit të materialeve në të njëjtat qytete  dhe në Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjakovë.

**Indikatori përkatës për këtë objektiv specifik:**

- *Përqindja e MND të hedhura në vendet e caktuara dhe të ricikluara – 60% deri në vitin 2023.*

# 3. Progresi financiar

## 3.1. Përdorimi i burimeve financiare (Qershor 2021 - Dhjetor 2022)

Zbatimi i SMIMK çon në përmirësime të mëdha në sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave. Progresi financiar për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit është treguar në Tabelat 15 dhe 16 e mëposhtme:

**Tabela 15. Progresi financiar drejt zbatimit të SMIMK**

| Shpenzimet e zbatimit | Buxheti për SMIMK | Buxheti i shpenzuar | Përqindja |
|---|---|---|---|
| Objektivi Strategjik 1: Shërbimet dhe Infrastruktura | 63,533,892 | 5,777,466 | 9% |
| Objektivi Strategjik 2: Profesionalizimi i sektorit të mbeturinave dhe riciklimit | 1.129.000 | 428,160 | 38% |
| Objektivi Strategjik 3: Rregullimi dhe Kontrolli | 13,097,250 | 146,250 | 1% |
| Objektivi Strategjik 4: Ekonomia qarkore | 27,386,523 | 558,464 | 2% |
| **Gjithsej (në euro)** | **105,146,665** | **6,910,340** | **6.5%** |

**Tabela 16. Progresi financiar drejt zbatimit të aktiviteteve të periudhës raportuese Qershor 2021 - Dhjetor 2022**

| Shpenzimet e zbatimit | Buxheti për Periudhën Raportuese 2021-2022 | Buxheti i shpenzuar | Përqindja |
|---|---|---|---|
| Objektivi Strategjik 1: Shërbimet dhe Infrastruktura | 39,240,733 | 5,777,466 | 15% |
| Objektivi Strategjik 2: Profesionalizimi i sektorit të mbeturinave dhe riciklimit | 1,129,000 | 428,160 | 38% |
| Objektivi Strategjik 3: Rregullimi dhe Kontrolli | 1,727,250 | 146,250 | 8% |
| Objektivi Strategjik 4: Ekonomia qarkore | 2,943,987 | 558,464 | 19% |
| **Gjithsej (në euro)** | **45,040,970** | **6,910,340** | **15%** |

Një zbatim i tillë financiar, më i ulët se sa pritej, justifikohet kryesisht nga rritja enorme e kostove si pasojë e krizave të fundit botërore që karakterizuan periudhën 2020-2022, që bëri të nevojshëm një rishikim thelbësor të prioriteteve dhe ndarjes së buxhetit për të zbatuar SMIMK brenda një kornize të re financiare.

Pavarësisht se analiza e kryer deri në Qershor 2022 duhet të integrohet me të dhëna shtesë, që ende mungojnë, raporti tashmë jep një pasqyrë të zbatimit të Strategjisë.

Varësisht nga nevojat dhe mundësitë buxhetore, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi bëhet edhe rishikimi i planit të veprimit për aktivitetet e caktuara.

## 3.2. Buxheti i kërkuar për financimin e prioriteteve gjatë periudhës 2023-2025

MMPHI, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e përfshira, ka identifikuar projektet prioritare me anë të 2 Planeve të reja të Veprimit që do të mbulojnë periudhat 2024-2026 dhe 2027-2030. Duhet të theksohet se projektet dhe kostot shoqëruese të cilat do të identifikohen në SMIMK, do të kenë në konsideratë ndryshimet të cilat kanë ndodhur si pasojë e rritjes së çmimeve për njësi që pasuan nga krizat e fundit botërore (pandemia, furnizimi me gaz, lufta e cila është duke vazhduar).

**Tabela 17. Projektet e dorëzuara për financim me buxhete të rishikuara, 2023-2025**

| Nr. | Titulli i projektit | Buxheti për SMIMK [Euro] | Buxheti i kërkuar prej donatorëve [Euro] | Periudha e zbatimit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ndërtimi i qendrave të kompostimit, klasifikimit dhe riciklimit të mbeturinave në rajonin e Prizrenit, Gjakovës, Ferizajt, Gjilanit dhe Pejës | 14.927.235 | 15.500.000 | 2023-2025 |
| 2 | Ndërtimi i magazinespër menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme | 3.500.000 | 13.000.000 | 2023-2025 |
| 3 | Ndërtimi i një qendre për klasifikimin dhe riciklimin e mbeturinave në rajonin e Prishtinës | 3.500.000 | 5.000.000 | 2023-2025 |
| 4 | Krijimi i qendrave për trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit të prodhuara në territorin e Kosovës | 5.875.000 | 10.900.000 | 2023-2025 |
| 5 | Përmirësimi dhe zgjerimi i deponisë ekzistuese në Mitrovicën e Jugut | 3.000.000 | 4.410.000 | 2023-2025 |
| 6 | Përmirësimi dhe zgjerimi i deponisë ekzistuese në Dragash | 2.090.000 | 3.090.000 | 2023-2024 |
| 7 | Përmirësimi i gjendjes teknike dhe operative në deponinë e rajonit të Prishtinës në Mirash-Obliq | 1.400.000 | 5.220.000 | 2023-2024 |
| | **TOTALI** | **34.292.235** | **57.120.000** | **2023-2025** |

Duhet theksuar se zbatimi i plotë dhe i drejtë i projekteve të lartcekura kërkon alokimin e buxhetit të nevojshëm nga institucionet përgjegjëse bartëse të projekteve për investimet që kërkohen të bëhen në këtë sektor.

# 4. Rreziqet dhe hapat për adresimin e tyre

## 4.1. Pengesat kryesore të zbatimit, rreziqet dhe zgjidhjet e propozuara

Tabela 18 paraqet pengesat kryesore të zbatimit, rreziqet dhe zgjidhjet e propozuara.

**Tabela 18. Pengesat kryesore të zbatimit, rreziqet dhe zgjidhjet e propozuara**

| Pengesat kryesore të zbatimit | Rreziqet dhe supozimet | Zgjidhjet e propozuara |
|---|---|---|
| **Rrethanat e forcës madhore (Covid-19).** Pandemia ka penguar miratimin në kohë të SMIMK dhe zbatimin e shumë prej aktiviteteve të parashikuara. | Vonesa në zbatimin e projekteve dhe rreziqet për dështimin e arritjes së objektivave të përcaktuara dhe indikatorëve të performancës | Edhe pse është e vështirë të parashikohen rrethanat e forcës madhore, pandemia e Covid-19 ka dëshmuar se institucionet prapë se prapë mund të përshtaten me kushtet dhe të ndërmarrin masa për zbatimin e aktiviteteve. |
| **Rritja e çmimeve për njësi.** Çmimet e njësive janë rritur ndjeshëm në vitet 2021-2022, për shkak të krizave të energjisë dhe luftës, gjë që bëri të nevojshme një rishikim thelbësor të buxhetit të përgjithshëm të pritshëm për disa projekte infrastrukturore. | Ndërprerja e procedurave të prokurimit për projektet infrastrukturore duke shkaktuar vonesa në zbatimin e projektit dhe pamundësi për të absorbuar burimet e dedikuara të financimit. Kjo sjell rrezike të zvarritjes serioze të zbatimit të projekteve infrastrukturore me ndikim të madh në arritjen e objektivave strategjike. | Ministritë dhe institucionet përgjegjëse bartëse të projekteve duhet të koordinohen me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për të gjetur zgjidhje apo alternativa brenda kornizës ligjore të Prokurimit Publik dhe Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë për të mundësuar rishikimin e kontratave dhe zbatimin e projekteve të përcaktuara në planin e veprimit. |
| Projektet për të cilat institucionet publike janë identifikuar si përgjegjëse duhet të kishin filluar tashmë, por zbatimi i tyre është vonuar. | Rreziqet për mos përmbushjen e afateve për zbatimin e projektit dhe dështimi për të përmbushur indikatorët dhe objektivat e përcaktuara, veçanërisht për Objektivat Strategjike 2 dhe 3. | MMPHI synon të iniciojë diskutime me institucionet përkatëse përgjegjëse dhe të lehtësojë fillimin e procesit të zbatimit. |
| **Komunat nuk janë aktive aq sa duhet.** Komunat zakonisht nuk janë proaktive çoftë për shkak të mungesës së burimeve financiare, ose për shkak të dështimit për të prioritizuar përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave si një fushë e përmirësimit. | Rreziqet për mos përmbushjen e afateve për zbatimin e projektit dështimi për të përmbushur indikatorët dhe objektivat e përcaktuara, veçanërisht për Objektivat Strategjike 1 dhe 4. | MMPHI do të vazhdojë të monitorojë zbatimin në kohë të SMIMK dhe PV, dhe do të veprojë si ndërmjetësues konsensusi me komunat në formulimin e projekteve dhe identifikimin e burimeve të financimit. Gjatë fazës së rishikimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit do të merren në konsideratë kapacitetet aktuale për të projektuar planifikimin realist të zbatimit të SMIMK. |
| **Mungesa e burimeve brenda MMPHI.** Stafi i MMPHI (3 zyrtarë) dhe AMMK (1 zyrtar) i përfshirë në të dhënat e menaxhimit të mbeturinave dhe në zbatimin dhe monitorimin e SMIMK nuk është i mjaftueshëm dhe ka nevojë për trajnime | Burimet e pamjaftueshme njerëzore në kuadër të MMPHI dhe AMMK-së e bëjnë shumë të vështirë për MMPHI-në përmbushjen e rolit të saj si institucion udhëheqës në zbatimin e SMIMK dhe PV. Vonesat në mbledhjen e të dhënave e bëjnë të vështirë identifikimin e statusit të zbatimit të projekteve. | Me mbështetjen e BE-së dhe GIZ-it, MMPHI ka zhvilluar një mjet monitorimi për të monitoruar zbatimin e SMIMK dhe PV, i cili ndihmon jashtëzakonisht shumë në gjurmimin e zhvillimit në kohë të aktiviteteve dhe raportimin për çdo pengesë madhore. Rritja e numrit të stafit të trajnuar, brenda Ministrisë dhe AMMK do të sigurojë mbledhjen në kohë të të dhënave, monitorimin e zbatimit të SMIMK dhe lehtësimin e procesit me të gjitha |

| Pengesat kryesore të zbatimit | Rreziqet dhe supozimet | Zgjidhjet e propozuara |
|---|---|---|
| specifike shtesë, duke synuar gjithashtu reduktimin progresiv të AT të jashtme kryesisht të ofruar nga GIZ. | | institucionet publike dhe palët e tjera të interesit të përfshira. |

## 4.2. Konsideratat për periudhën e ardhshme raportuese

Siç u përmend tashmë, periudha raportuese ka qenë një periudhë sfiduese e paprecedentë për zbatimin e SMIMK dhe projekteve prioritare të menaxhimit të mbeturinave, për shkak të kufizimeve të pandemisë nga COVID-19 që kanë vazhduar edhe pas vitit 2020 të kombinuara me kapacitetet e limituara në të gjitha nivelet.

Pavarësisht sfidave dhe objektivave ambicioze të Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave në Kosovë 2021-2030 dhe Planit të Veprimit 2021-2023, është shënuar progres në zbatimin e Strategjisë.

Objektivi që lidhet me mbulimin prej 80% të shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave është arritur gjithashtu plotësisht, duke shkuar drejt mbulimit të plotë prej 100%, që pritet të realizohet në vitin 2024, pra 2 vite përpara afatit të planifikuar të vitit 2026.

Sistemi për monitorimin e zbatimit të SMIMK është krijuar, dhe pavarësisht sfidave në mbledhjen e të dhënave, veçanërisht nga komunat, sipas diskutimeve të zhvilluara nga përfaqësuesit e grupit punues për monitorimin e zbatimit të SMIMK, mjeti i monitorimit duhet të thjeshtohet dhe të realizohen më shumë takime për t'u aftësuar në zbatimin e plotë të mjetit të monitorimit.

Pavarësisht sfidave të lartpërmendura, zbatimi i përgjithshëm i SMIMK dhe Planit të Veprimit përkatës 2021-2023 konsiderohet të jetë i kënaqshëm, duke marrë parasysh se 35 (51%) nga 69 aktivitetet e parashikuara në tërësi, tashmë kanë filluar (14 të përfunduara) në periudhën 2021-2022. Pavarësisht buxhetit të përgjithshëm të paraparë për SMIMK prej 105.1 milionë Euro, deri më tani buxheti i shpenzuar për zbatimin e Strategjisë mbetet relativisht i kufizuar në rreth (7%) ose 7.6 milionë Euro. Për më tepër, grupi punues ka hasur në vështirësi të identifikojë buxhetin real të alokuar për zbatimin e aktiviteteve të SMIMK.

MMPHI, në bazë të diskutimeve dhe përvojës së krijuar në monitorimin e zbatimit të SMIMK, do të bëjë rishikimin e mjetit të monitorimit për ta thjeshtuar më tutje mjetin si dhe do të organizoj takime më të shpeshta me palët e përfshira në zbatim të SMIMK. Në këtë drejtim, do të analizohen mënyrat më të përshatshme të mbledhjes së të dhënave për sa i përket nivelit qendror dhe atij lokal.

MMPHI do të vazhdojë angazhimin e saj në krijimin e kornizës ligjore dhe institucionale për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit. Në këtë drejtim, do të analizohen katër fraksione të mbeturinave sikurse: pajisjet elektrike dhe elektronike, bateritë dhe akumulatorët, vajrat dhe automjetet jashtë përdorimit ku nga katër këto fraksione - tre do të krijohen.

Vlen të theksohet fakti se sikurse sistemi i rimbursimit të depozitave, po ashtu edhe iniciativa e reduktimit të përdorimit të qeseve të plastikës dhe krijimi i skemave për tre nga katër fraksionet e mbeturinave e: Paisjeve Elektrike dhe Elektronike, Bateritë dhe Akumulatorët Vajrat dhe Automjetet Jashtë Përdorimit, bëhet për herë të parë në vend. Në këtë drejtim, ka mungesë të përvojës dhe njohurive nga institucionet e nivelit qendror dhe atij lokal shto faktin se korniza ligjore

për krijimin e entiteteve ligjore jofitimprurëse del të jetë e mangët, ku si rrjedhojë realizimi i këtyre aktiviteteve shihet si sfidë që mund të shpie në vonesa për krijimin e këtyre mekanizmave. Për të adresuar këto çështje, MMPHI do të zhvillojë analiza krahasimore me vendet tjera të cilat kanë kaluar nëpër këtë fazë në mënyrë që nxjerrë mësime si dhe të përafroj legjislacionin vendor me atë të Bashkimit Evropian.

Për sa i përket procesit të reduktimit të përdorimit të qeseve të plastikës dhe sistemit të rimbursimit të depozitës, MMPHI është në fazën e finalizimit të Udhëzimit Administrativ për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit me çrast, reduktimi i përdorimit të qeseve të plastikës do të filloj së zbatuari në vitin 2023 ndërsa, sistemi i rimbursimit të depozitave do të bëhet funksional në vitin 2025 përderisa bisedimet dhe aktivitetet për krijimin e këtij sistemi do të fillojnë nga pjesa e dytë e vitit 2023. I tërë sistemi i rimbursimit të depozitës do të bazohet në planin biznesor si dhe në kornizën ligjore përkatëse për të garantuar qëndrueshmërinë financiare të sistemit.

# Anekset

## Shtojca 1. Aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve

| Nr. | Fusha e zhvillimit të kapaciteteve | Grupi i synuar i përfshirë |
|---|---|---|
| 1 | Hartimi i objektivave të planeve të menaxhimit të mbeturinave | Zyrtarët komunalë të komunave të Gjakovës, Junikut, Mamushës, Parteshit dhe Vitisë |
| 2 | Trajnimi i Trajnerëve të IKAP | TiT (Trajnimi i Trajnerëve) |
| 3 | Punëtori për analizën organizative dhe financiare të KRM Uniteti sh.a | Anëtarët e KRM Uniteti |
| 4 | Punëtori për manualin e AMMK-së dhe shabllonet e raportimit për Grantin e Performancës | AMMK, KMDK, MMPHI, KR-të |
| 5 | Punëtori me 9 komuna për vlerësimin e nevojave të Granteve të Performancës për Mjedis të Pastër | Komunat: Viti, Suharekë, Han i Elezit, Mamushë, Rahovec, Gjilan, Junik, Ranillug |
| 6 | TiT - Vlerësimi i nevojave (Granti i Performancës) | AMMK |
| 7 | Analiza e ndarjes së mbeturinave komunale | Nivel lokal dhe qendror<br>(Drejtorët, Zyrtarët e shërbimeve publike dhe AKMM) |
| 8 | Ngritja e kapaciteteve në nivel lokal dhe qendror për kryerjen e analizave të fraksioneve të mbeturinave | • Drejtorët e shërbimeve publike;<br>• Zyrtarë të shërbimeve publike, sektori i menaxhimit të mbeturinave;<br>• Menaxherët e njësive brenda NP-së<br>• Stafi nga NP |
| 9 | Hartimi i udhëzuesit kombëtar për kategorizimin e deponive ilegale | Drejtorët, Zyrtarët e shërbimeve publike dhe AKMM |
| 10 | Përdorimi i mjeteve të planifikimit dhe hartimi i planeve të veprimit për eliminimin e deponive ilegale | • Drejtori i shërbimeve publike;<br>• Zyrtarët e shërbimeve publike, sektori i menaxhimit të mbetjeve; |
| 11 | Punëtori për Planin e Menaxhimit të Mbeturinave Komunale | Komuna e Dragashit |
| 12 | Punëtori për Planin Operativ të Menaxhimit të Mbeturinave për Komunën e Prishtinës | Komuna e Prishtinës |
| 13 | Punëtori për Planin e Menaxhimit të Mbeturinave Komunale | Komuna e Dragashit |
| 14 | Punëtoria "Finalizimi i Planit Operativ për Menaxhimin e Mbeturinave për Komunën e Prishtinës" | Zyrtarët komunalë të Prishtinës |
| 15 | Punëtoria për procesin e përcaktimit të tarifave për TKL dhe asgjësimin për Komunën e Junikut | Zyrtarët komunalë të Junikut |
| 16 | Punëtori për procesin e përcaktimit të tarifave për TKL dhe hedhjen për Komunën e Kamenicës | Zyrtarët komunalë të Kamenicës, Ekohigjiena |
| 17 | Punëtoria mbi procesin e përcaktimit të tarifave për TKL dhe hedhjen për Komunën e Vitisë | Zyrtarët komunalë të Vitisë, Partesh |
| 18 | Punëtoria mbi procesin e përcaktimit të tarifave për TKL dhe hedhjen për Komunën e Mamushës | Zyrtarët komunalë të Mamushës |
| 19 | Trajnim për Zhvillimin e Kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile | Shoqëritë Civile |
| 20 | Punëtoria e KIPA TiT Faza II | Zyrtarë komunalë nga të gjitha komunat |
| 21 | Punëtori për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave | MMPHI, ME, PTA |
| 22 | Monitorimi i zbatimit të Strategjisë së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave | Përfaqësues të MMPHI-së, përfaqësues nga ministritë e tjera të linjës përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të planit të veprimit |
| 23 | Raportimi vjetor i AMMK | DSHPK, ZMM, KRM |
| 24 | Ngritja e kapaciteteve në ndërmarrjet publike përmes kualifikimit të komisionit profesional për ligj, financa dhe operacional në NP dhe KLMC | PAMKOS- KRM |
| 25 | Rritja e performancës së shërbimeve komunale | PAMKOS- KRM |
| 26 | Politikat e menaxhimit | PAMKOS- KRM |
| 27 | Vlerësimi i nevojave për mbrojtjen dhe sigurinë në punë | PAMKOS- KRM |

| Nr. | Fusha e zhvillimit të kapaciteteve | Grupi i synuar i përfshirë |
|---|---|---|
| 28 | Rritja e performancës së ndërmarrjeve | PAMKOS- KRM |
| 29 | Punëtori/vizitë studimore për DSHPK- Mali i Zi | Drejtorët Komunal të Departamenteve të Shërbimit Publik, MMPHI, MAPL, AMMK, AKK |
| 30 | Punëtori/vizitë studimore për ZMM- Bullgari | Zyrtarë për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale, MMPHI, MAPL, AMMK, AKK |
| 31 | Trajnimi për digjitalizimin e AKMM | AMMK, MMPHI |
| 32 | Granti i Performancës Komunale - Mjedis i pastër - trajnim për përdorimin e kamionëve | Zyrtarë komunalë, vozitës dhe mekanikë të KRM-ve |
| 33 | Vizitë studimore në Turqi për BNK | Kryetarët e komunave |
| 34 | Vizitë studimore në Estoni për SRD | MMPHI (Ministri, Zv.Ministri, DKM) |
| 35 | Vizitë studimore në Estoni për dixhitalizimin e sistemit të raportimit | AMMK |

# Shtojca 2. Tabela e statusit të zbatimit të aktiviteteve të SMIMK

| Nr | Aktiviteti | Statusi i progresit | Institucioni përgjegjës | Sqarim i shkurtër i progresit |
|---|---|---|---|---|
| **1** | **Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i një gjenerate të re të shërbimeve dhe infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbeturinave** | | | |
| 1.1 | **Objektivi specifik: Ofrimi i shërbimeve të rregullta dhe të besueshme të mbledhjes së mbeturinave të ngurta komunale për tërë popullatën** | | | |
| 1.1.1 | Zbatimi i granteve të performancës sipas IKP-ve për shërbimet e mbeturinave komunale | plotësisht i zbatuar | MMPHI | 28 komuna janë mbështetur nga BE/GDC (BGjZh)në hartimin e planeve të tyre për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale. Ndërsa, për të gjitha komunat është përgatitur Rregullorja Model për Menaxhimin e Mbeturinave në nivel të Komunës ku tanimë komunat i kanë përgatitur draftet e tyre në përputhje me Rregulloren Model e cila është në harmoni me Ligjin për Mbeturina dhe Ligjin për Kundërvajtje. |
| 1.1.2 | Zgjerimi i shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave | pjesërisht i zbatuar | MMPHI | Progres i konsiderueshëm është bërë në zgjerimin e mbulimit të shërbimeve të mbledhjes, që raportohet të jetë mbi 90.2% e popullsisë që në vitin 2021, duke përmbushur kështu cakun e ndërmjetëm për vitin 2023, por jo ende 100% (caku për vitin 2030). GIZ mbështeti AMMK-në në dizajnimin e shablloneve të standardizuara të raportimit, duke çuar në struktura të standardizuara raportuese si dhe në krijimin institucional të Treguesve të Performancës në menaxhimin e mbeturinave. Janë mbajtur një sërë trajnimesh dhe disa takime për kapacitetin e ZMM-ve, DSHP-ve dhe KRM-ve për të shfrytëzuar shabllonet e raportimit. |
| I.1.1a | Asistenca teknike për zbatimin e granteve të performancës sipas IKP-ve për shërbimet e mbeturinave komunale | plotësisht i zbatuar | BE/GDC (BGjZh) | BE/GIZ kanë mbështetur në vazhdimësi procesin e zbatimit të grantit të performancës deri në përfundimin e plotë të tij, kur edhe kanë organizuar ceremoninë e ndarjes së çmimeve për komunat përfituese dhe përmbylljes së aktivitetit. . |
| I.1.3 | Mbështetje për të gjitha komunat për t'i realizuar shërbimet themelore të menaxhimit të mbeturinave në përputhje me Ligjin dhe drejt qëndrueshmërisë | pjesërisht i zbatuar | BE/GDC (BGjZh) | Gjatë vitit 2021 dhe vitit 2022 BE/GIZ ka organizuar trajnime dhe sesione të ndryshme me drejtorët e drejtorive të shërbimeve publike, udhëheqësit e sektorëve si dhe zyrtarët përkatës për menaxhimin e mbeturinave të cilat kanë pasur qëllim ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve në: planifikimin, realizimin si dhe menaxhimin e proceseve në kuadër të komunës. |

| Nr | Aktiviteti | Statusi i progresit | Institucioni përgjegjës | Sqarim i shkurtër i progresit |
|---|---|---|---|---|
| 1.2 | **Objektivi specifik: Zhvillimi i rrjetit të integruar të qendrave të menaxhimit të mbeturinave** | | | |
| 1.2.1 | Studimi i fizibilitetit dhe dizajni për transfer stacionet dhe qendrat e ndarjes në Klinë, Istog, Skenderaj, Novobërdë | pjesërisht i zbatuar | KOM | Termat e Referencës për stacionin e transferimit të Istogut janë përgaditur. |
| 1.2.2 | Ndërtimi i transfer stacioneve dhe qendrave të ndarjes në Klinë, Istog, Skenderaj, Novobërdë | nuk ka filluar zbatimi | KOM | |
| 1.2.10 | Studimi i fizibilitetit për përmirësimin dhe zgjerimin e deponisë ekzistuese në Pejë | plotësisht i zbatuar | KOM | Studimi i fizibilitetit është hartuar dhe finalizuar. |
| 1.2.11 | Përmirësimi dhe zgjerimi i deponisë ekzistuese në Pejë | pjesërisht i zbatuar | KOM | Nga informacionet e marra, për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia COVID 19 dhe krizave të fundit për furnizimin me produkte të caktuara (dru, çelik, energji, pajisje pune dhe makineri etj.), rritja e çmimeve përkatëse të materialeve të ndërtimit ka ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në këtë projekt. Komuna e Pejës me mbështetjen e KfW-së është në fazën e përzgjedhjes së konsulencës për zhvillimin e vlerësimit të studimit. Bazuar në këtë studim, do të fillohet me realizimin e punëve konkrete për çka edhe është nënshkruar Memorandum Bashkëfinancimi tre-palësh me KFW dhe BE. |
| 1.2.12 | Mbikëqyrja për përmirësimin dhe zgjerimin e deponisë ekzistuese në Pejë | nuk ka filluar zbatimi | KOM | Ky aktivitet mund të fillojë vetëm pasi të nënshkruhet kontrata për punimet si dhe është i lidhur me aktivitetin 1.2.11 |
| 1.2.13 | Përmirësimi dhe zgjerimi i deponisë ekzistuese në Dragash | pjesërisht i zbatuar | KOM | Deri më tani është identifikuar lokacioni për përmirësimin dhe zgjerimin e deponisë si dhe me mbështetjen e JICA janë siguruar disa nga mjetet e nevojshme teknike për kryerjen e veprimeve në deponi. Po ashtu, komuna e Dragashit ka ndërmarrë veprime përkatëse në përmirësimin e deponisë. |
| 1.2.14 | Mbikëqyrja për përmirësimin dhe zgjerimin e deponisë ekzistuese në Dragash | të fillojë pas vitit 2022 | KOM | Ky aktivitet është i lidhur me zbatimin e aktivitetit 1.2.13 dhe si rrjedhojë do të zbatohet gjatë vitit 2023. |
| 1.2.15 | Studimi i fizibilitetit për vlerësimin e deponisë në Mirash - Obiliq dhe zhvillimi i konceptit | pjesërisht i zbatuar | MMPHI | Ështe hartuar drafti i pare fillestar i Studimit të fizibilitetit pë deponinë Mirash-Obiliq |
| 1.2.16 | Përmirësimi i gjendjes teknike dhe operative në deponinë e rajonit të Prishtinës në Mirash - Obiliq | nuk ka filluar zbatimi | KMDK | |
| 1.2.17 | Mbikëqyrja e punëve për përmirësimin e | të fillojë pas vitit 2022 | KMDK | Ky aktivitet mund të fillojë vetëm pasi të nënshkruhet kontrata për punimet |

| Nr | Aktiviteti | Statusi i progresit | Institucioni përgjegjës | Sqarim i shkurtër i progresit |
|---|---|---|---|---|
| | gjendjes teknike dhe operative në deponinë e rajonit të Prishtinës në Mirash - Obiliq | | | |
| 1.2.18 | Përmirësimi dhe zgjerimi i deponisë së Gjilanit | nuk ka filluar zbatimi | KMDK | Vetëm studimi i fizibilitetit është zhvilluar. |
| 1.2.19 | Mbikëqyrja për përmirësimin dhe zgjerimin e deponisë së Gjilanit | të fillojë pas vitit 2022 | KMDK | |
| 1.2.30 | Eliminimi ose rehabilitimi i deponive të paligjshme dhe të pakontrolluara të mbeturinave | pjesërisht i zbatuar | KOM | Numri i deponive ilegale është zvogëluar falë përpjekjeve të bëra nga shumë komuna të Kosovës duke shfrytëzuar buxhetin e tyre. Përpjekje të mëtejshme janë në zbatim sepse mbyllja e deponive ilegale mbetet brenda prioriteteve kryesore të zbatimit të SMIMK. Komunat raportuan se 304 deponive të tjera ilegale u mbyllën në periudhën 2020-2021, duke arritur cakun e pritshëm. Të dhënat e mbledhura në teren nga AMMK, tregojnë se në vitin 2022 numri i deponive ilegale është gjithsej 763. Të dhënat lidhur me numrin e deponive ilegale do të zyrtarizohen me publikimin e raportit vjetor të sektorit të menaxhimit të mbeturinave i cili publikohet në tre mujorin e parë të vitit 2023. |
| 1.2.30a | Asistenca Teknike për 1.2.30 | pjesërisht i zbatuar | BE/GDC (BGjZh) | Ky aktivitet është i ndërlidhur me zbatimin e aktivitetit 1.2.30 ku BE/GIZ ka ofruar asistencë teknike për realizimin e këtij aktiviteti. |
| 1.2.3 | Mbikëqyrja për ndërtimin e transfer stacioneve dhe qendrave të ndarjes në Klinë, Istog, Skenderaj, Novobërdë | të fillojë pas vitit 2022 | KOM | |
| 1.2.4 | Studimi i fizibilitetit për krijimin e transfer stacionit në Malishevë | nuk ka filluar zbatimi | KOM | Asnjë informacion për arsyet e vonesës së këtyre aktiviteteve nuk është marrë nga komuna përkatëse. |
| 1.2.5 | Ndërtimi i transfer stacionit në Malishevë | nuk ka filluar zbatimi | KOM | |
| 1.2.6 | Mbikëqyrja për ndërtimin e transfer stacionit në Malishevë | të fillojë pas vitit 2022 | KOM | |
| 1.2.7 | Studimi i fizibilitetit për transfer stacionin dhe qendrën e ndarjes në Ferizaj | nuk ka filluar zbatimi | KOM | Ky aktivitet tani do të kombinohet me projektin e deponisë, i financuar nga KfW dhe i përshkruar më sipër. |
| 1.2.8 | Ndërtimi i transfer stacionit dhe qendrës së ndarjes në Ferizaj | të fillojë pas vitit 2022 | KOM | |
| 1.2.9 | Mbikëqyrja për ndërtimin e transfer stacionit dhe qendrës së ndarjes në Ferizaj | të fillojë pas vitit 2022 | KOM | |
| 1.3 | **Objektivi specifik: Zhvillimi i sistemeve për kontrollimin dhe menaxhimin e mbeturinave të tjera** | | | |
| 1.3.1 | Plani i hollësishëm i menaxhimit të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit | plotësisht i zbatuar | MMPHI | MMPHI me mbështetjen e BERZH ka zhvilluar planin e hollësishëm për menaxhimin e |

| Nr | Aktiviteti | Statusi i progresit | Institucioni përgjegjës | Sqarim i shkurtër i progresit |
|---|---|---|---|---|
| | | | | mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit. |
| 1.3.2 | Rishikimi i udhëzimit administrativ për menaxhimin e MRr-ve | nuk ka filluar zbatimi | MMPHI | |
| 1.3.3 | Ndërtimi i qendrave për trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit në komunat e Kosovës | nuk ka filluar zbatimi | KOM | vetëm komuna e Prizrenit ka raportuar se ka filluar me plotësimin e formularit për grante për KIBP që sipas saj do të përfundojë brenda tremujorit të parë të vitit 2023. Ndërkaq, Komuna e Pejës ka raportuar se aktualisht është në proces të hartimit të sistemit për Menaxhimin e Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënimit në Kosovë përmes konsulencës, duke u fokusuar në objektivat e menaxhimit të MNRr-ve, infrastrukturën dhe vendndodhjen, si dhe elementet përkatëse institucionale dhe financiare. |
| 1.3.4 | Mbikëqyrja për ndërtimin e qendrave për trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit në komunat e Kosovës | të fillojë pas vitit 2022 | KOM | |
| 1.3.8 | Plani i hollësishëm për menaxhimin e mbeturinave medicinale | plotësisht i zbatuar | INST | Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me MMPHI-në dhe mbështetjen e GIZ-it e ka hartuar draft Planin e hollësishëm të menaxhimit të mbeturinave medicinale/spitalore në vitin 2022 si dhe i ka realizuar konsultimet e nevojshme me palët e përfshira në proces. |
| 1.3.9 | Plani i hollësishëm për menaxhimin e mbeturinave të kafshëve dhe nënprodukteve të kafshëve | nuk ka filluar zbatimi | INST | Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës ka raportuar se gjatë vitit 2022 se kanë siguruar mbështetje financiare për zhvillimin e studimit të fizibilitetit i cili do të jap një pasqyrë të qartë të mënyrës së funksionalizimit të Fabrikës së Riciklimit. |
| **2.** | **Objektivi Strategjik 2: Profesionalizimi i sektorit të menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave** | | | |
| 2.1 | **Objektivi specifik: Vazhdimi i ndërtimit të kapaciteteve profesionale në sektorin publik dhe privat** | | | |
| 2.1.1 | Mbështetja e MMPHI-së në monitorimin e SKMMN-së, rishikimin/azhurnimin e Planit të Veprimit dhe dergimit e projekteve drejt zbatimit | pjesërisht i zbatuar | BE/GDC (BGjZh) | BE/GIZ ka mbështetur institucionet në krijimin e strukturës (grupi punues ndërministror) përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Strategjisë së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në përputhje me Udhëzimin Administrativ për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit. Gjithashtu, BE/GIZ ka ofruar mbështetje për MMPHI-në me instrumentin e |

| Nr | Aktiviteti | Statusi i progresit | Institucioni përgjegjës | Sqarim i shkurtër i progresit |
|---|---|---|---|---|
| | | | | monitorimit që do të lehtësojë punën e grupit punues ndërministror. Për këtë qëllim janë përcaktuar personat e kontaktit përgjegjës për raportimin dhe monitorimin e zbatimit të planit të veprimit në ministritë e linjës dhe institucionet e tjera përgjegjëse të parashikuara në planin e veprimit. Dy tryeza të rrumbullakëta me anëtarët e grupit të punës janë mbështetur dhe lehtësuar nga GIZ. Grupi i punës ndërministror ka mbledhur të gjitha të dhënat përkatëse për të përcaktuar statusin aktual të zbatimit të secilit aktivitet të planit të veprimit për të mundësuar rishikimin e planit të veprimit dhe rishikimin e objektivave të riciklimit. Për rishikimin e Strategjisë dhe zhvillimin e Planit të Veprimit 2024-2026, BE/GIZ ka kontraktuar konsulencë ndërkombëtare për të ofruar mbështetje për MMPHII në zhvillimin e planit të ri të veprimit dhe rishikimin e objektivave të riciklimit të Strategjisë. Procesi i rishikimit të Strategjisë fillon në Janar 2023. |
| 2.1.2 | Masat e posaçme të kualifikimit për ekspertizën në MMN | pjesërisht i zbatuar | BE/GDC (BGjZh) | |
| 2.2 | **Objektivi specifik: Caktimi i një kodi industrial për sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave në statistikat kombëtare** | | | |
| 2.2.1 | Mundësimi dhe raportimi i vendeve të punës dhe bizneseve që kanë të bëjnë me mbeturinat në statistikat kombëtare | pjesërisht i zbatuar | INST (Agjensia e Statistikave të Kosovës) | Diskutimet do të vazhdojnë në mars të vitit 2023 pasi ASK-ja ka hasur në vështirësi në përcaktimin e metodologjisë së kodifikimit dhe raportimit. |
| 2.2.2 | Mbështetja e krijimit të një sistemi të trajnimit dhe akreditimit | nuk ka filluar zbatimi | INST | |
| 2.2.3 | Mbështetja për formalizimin apo njohjen e akterëve joformalë në MMN | pjesërisht i zbatuar | BE/GDC (BGjZh) | 200 akterë jo-formalë dhe familjet e tyre janë intervistuar dhe është bërë një hartëzim social i kushteve të tyre të jetesës. Një vlerësim/anketë është bërë për të hedhur dritë edhe mbi fraksionin e mbeturinave të mbledhura nga akteorët jo-formalë dhe sasinë e rikuperuar dhe një raport mbi këtë do të publikohet deri në mars 2023. Këto të dhëna nuk ekzistojnë në asnjë hulumtim të mëparshëm dhe mund të shihet si diçka inovative. Të dhënat nga ky veprim do të shërbejnë për të integruar akterët jo-formalë në hartimin e politikave vendore dhe në planet e menaxhimit të |

| Nr | Aktiviteti | Statusi i progresit | Institucioni përgjegjës | Sqarim i shkurtër i progresit |
|---|---|---|---|---|
| | | | | integruar ndërkomunal të mbeturinavePlanet Ndër-Komunale për Menaxhim të Integruar të Mbeturinave si dhe në plane dhe kuadre të politikave të tjera. |
| 2.3 | **Objektivi specifik: Promovimi i hulumtimit dhe zhvillimit në universitete** | | | |
| 2.3.1 | Hartimi ose përshtatja e planprogrameve të përshtatshme të arsimit të lartë për MMN-në | nuk ka filluar zbatimi | MASHT | |
| 2.3.2 | Lidhja e partneritetit me universitetet evropiane për shkëmbim të njohurive dhe hulumtim | nuk ka filluar zbatimi | MASHT | MMPHI do të jetë në kontakt me MASHT-in për të mësuar nëse partneriteti me një universitet evropian është eksploruar dhe cili është statusi i këtij aktiviteti. |
| **3.** | **Objektivi Strategjik 3: Forcimi i rregullimit dhe kontrollit në sektorin e menaxhimit të mbeturinave duke i plotësuar boshllëqet dhe duke i qartësuar mekanizmat e zbatimit** | | | |
| 3.1 | **Objektivi specifik: Krijimi i një sistemi informativ funksional për menaxhimin e mbeturinave** | | | |
| 3.1.1 | Hartimi i SIMM-së | plotësisht zbatuar | AMMK | Një aplikacion për menaxhimin e mbeturinave i bazuar në internet filloi të zhvilohet në fillim të vitit 2022 dhe u finalizua në dhjetor të po këtij viti. Në shkurt 2023 pritet të mbahen trajnime në lidhje me këtë aplikacion, ndërsa i qasshëm për publikun ai do të jetë vetëm në fund të vitit 2023 duke marrë parasysh kohën që merr procesi në lidhje me dizajnimin dhe faktorë të tjerë teknikë. |
| 3.1.2 | Ofrimi i trajnimit dhe mbikëqyrjes për operatorët e mbeturinave për ta përmirësuar cilësinë dhe disponueshmërinë e të dhënave | plotësisht i zbatuar | AMMK | Nevojat për trajnim për operatorët e mbeturinave janë identifikuar në vitin 2018 dhe janë ofruar trajnime për operatorët e mbeturinave për të përmirësuar cilësinë dhe disponueshmërinë e të dhënave. |
| 3.1.3 | Avancimi i funksioneve institucionale në monitorim dhe raportim (AMMK) | plotësisht i zbatuar | BE/GIZ | Të gjitha aktivitetet janë realizuar plotësisht, nëpërmjet mbështetjes nga BE dhe GIZ |
| 3.2 | **Objektivi specifik: Zgjerimi i sistemit të dhënies së licencave dhe lejeve për menaxhimin e mbeturinave për t'i mbuluar të gjitha mbeturinat, operatorët dhe qendrat e menaxhimit të mbeturinave** | | | |
| 3.2.1 | Hartimi i përshkrimeve të punës, kërkesave për punësim të stafit dhe vlerësim të nevojave për trajnim për ministritë përkatëse dhe AMMK-në | pjesërisht i zbatuar | MMPHI | MMPHI-ja gjatë vititi 2022 ka filluar me hartimin e draft Rregullores për Ri-organizmin dhe sistematizimin e vendeve të punës të MMPHI e cila draft Rregullore ende nuk është miratuar. Zhvillimi i kërkesave për personel dhe nevoja për trajnim varet nga ri-organizimi i ministrisë i cili do të realizohet përmes Rregullores së re. |
| 3.2.2 | Zhvillimi i një programi të kualifikimit të bazuar në vlerësimin e nevojave për tërë stafin e AMMK-së | pjesërisht i zbatuar | AMMK | Vlerësimi i nevojave është bërë pjesërisht me theks të veçantë në ngritjen e Kadastrës së mbeturinave të rrezikshme dhe |

| Nr | Aktiviteti | Statusi i progresit | Institucioni përgjegjës | Sqarim i shkurtër i progresit |
|---|---|---|---|---|
| | | | | kimikateve. Programi i kualifikimit do të pasojë pas përfundimit të vlerësimit të nevojave. |
| 3.2.3 | Krijimi i SIE-së, përmirësimi i bazës së të dhënave për të gjithë prodhuesit e mbeturinave, përfshirë impiantet e mëdha të renditura në leje sipas Direktivës 2010/75/EU (Aneksi I) | pjesërisht i zbatuar | AMMK | Ppërmirësimi i bazës së të dhënave për gjeneruesit e mbeturinave është bërë, por ende nuk përfshin instalimet e mëdha të listuara në leje sipas Direktivës 2010/75/EU. Aktualisht, baza e të dhënave është e disponueshme vetëm për komunat, operatorët e mbeturinave dhe transportuesit. |
| 3.2.4 | Plani për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme | nuk ka filluar zbatimi | MMPHI | Plani pritet të hartohet në vitin 2023. Një plan i tillë duhet të përfshihet në aktivitetet përgatitore të projektit të përgjithshëm për ndërtimin e objektit të magazinimit dhe trajtimit të mbeturinave të rrezikshme. Një udhëzues mbi “Mbeturinat e rrezikshme” është duke u zhvilluar nga BE dhe MMPHI/është zhvilluar nga BE dhe MMPHI dhe është publikuar në javën e parë të muajit Shkurt 2023. |
| 3.2.5 | Ndërtimi i qendrës së menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme | të filloje pas vitit 2022 | MMPHI | Duke marrë parasysh miratimin e SMIMK me vonesë në maj 2021, fillimi i një projekti të tillë u shty për në vitin 2023. |
| 3.2.6 | Mbikëqyrja e ndërtimit të qendrës së menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme | të filloje pas vitit 2022 | MMPHI | Ky aktivitet do të nisë vetëm pasi të nënshkruhet kontrata për ndërtimin e objektit të mbeturinave të rrezikshme. |
| 3.3 | **Objektivi specifik: Forcimi i mekanizmave zbatues, ndërlidhur me komunat dhe inspektoratet** | | | |
| 3.3.1 | Rishikimi i mekanizmave të zbatimit nga AMMK-ja, në bashkëpunim të ngushtë me komunat | nuk ka filluar zbatimi | MMPHI | |
| 3.3.2 | Të miratohen dhe zbatohen amendamentet e nevojshme rregullative (kompetencat dhe gjobat e reja) duke u bazuar në shqyrtim | të filloje pas vitit 2022 | INST | |
| 3.3.3 | Programi i veçantë i trajnimit për zyrtarët/stafin e zbatimit | të filloje pas vitit 2022 | MMPHI | |
| 4 | **Objektivi Strategjik 4: Promovimi i vlerave dhe praktikave të një ekonomie qarkore** | | | |
| 4.1 | **Objektivi specifik: Ngritja e vetëdijes për rëndësinë dhe dobitë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave** | | | |
| 4.1.1 | Komunikimi i strategjisë tek palët e interesuar dhe publiku | plotësisht i zbatuar | MMPHI | |
| 4.1.2 | Hartimi i një programi të përgjithshëm për ndryshimin e sjelljes me fushat kryesore të ndërhyrjes dhe grupet e synuara | pjesërisht i zbatuar | MMPHI | Në këtë drejtim, MMPHI para dhe pas miratimit të Udhëzimit Administrativ për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit, do të filloj me fushata ndërgjegjësimi për reduktimin e përdorimit të |

| Nr | Aktiviteti | Statusi i progresit | Institucioni përgjegjës | Sqarim i shkurtër i progresit |
|---|---|---|---|---|
| | | | | qeseve të plastikës në përputhje me masat e propozuara në Udhëzimin Administrativ. |
| 4.1.3 | Zbatimi i fushatës 2020-2022 duke përfshirë publikimin e rezultateve | plotësisht i zbatuar | MMPHI | MMPHI ka zhvilluar fushata vetëdijësuese në kuadër të kalendarit të festave mjedisore me çrast përfituesë kanë qenë qytetarë, nxënës dhe shoqëria në përgjithësi. |
| 4.1.4 | Të ndryshohet planprogrami shkollor për fazat kryesore me njohuritë për MIMN-në dhe qëndrimin për mjedisin | nuk ka filluar zbatimi | INST | Të mësuarit e strukturuar duhet të përfshihet në kurrikulën e shkollës. MMPHI do të ndjekë procesin me MASHT-in për të sqaruar nëse janë iniciuar diskutime të brendshme. |
| 4.1.5 | Të ofrohen masa të trajnimit për mësimdhënësit ose akterët e ndryshëm për planprogramet e ndryshuara | të filloje pas vitit 2022 | INST | |
| 4.1.6 | Fushata e vetëdijesimit në komunat e Pejës, Istogut, Klinës, Deçanit dhe Junikut lidhur me deponinë e re | pjesërisht i zbatuar | KOM | Komuna e Deçanit dhe Junikut kanë paraparë fushata vetëdijësimi për qytetarët e këtyre komunave. |
| 4.1.7 | Fushata e vetëdijesimit në komunën e Dragashit lidhur me deponinë e re | të filloje pas vitit 2022 | KOM | |
| 4.1.8 | Masat e vetëdijesimit dhe komunikimit publik lidhur me ndërtimin e qendrave të trajtimit për MNRr-ve | të filloje pas vitit 2022 | KOM | |
| 4.2 | **Objektivi specifik: Stimulimi i risive në parandalimin e mbetjeve** | | | |
| 4.2.1 | Krijimi i bazës së nevojshme ligjore kombëtare për zhvillimin Përkthimi i kërkesave të nevojshme për etiketim në rregulloret kombëtare | pjesërisht i zbatuar | MMPHI | Ky aktivitet duhet të përfundojë deri në fund të vitit 2023, siç ishte planifikuar fillimisht. Për këtë qëllim, MMPHI ka hartuar ndryshime në Ligjin për Mbeturinat për të harmonizuar më tej legjislacionin kombëtar me Acquis të BE-së. Gjithashtu, projektligji krijon bazën ligjore që Qeveria të përcaktojë më tej kriteret dhe kërkesat për të futur me sukses Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesit dhe Sistemin e Rimbursimit të Depozitave që do të adresohen në aktet nënligjore për paketimin dhe mbetjet e paketimit. |
| 4.2.2 | Zhvillimi i skemës së granteve për inovacion me kritere të përshtatshmërisë, dizajn të konkurrencës dhe burime të financimit | nuk ka filluar zbatimi | INST | Ky aktivitet nuk ka filluar ende. Institucioni përgjegjës është Ministria e Ekonomisë. Aktiviteti ishte planifikuar të fillonte në shkurt të vitit 2022 dhe të përfundonte në fund të vitit 2023. |
| 4.2.3 | Shpërndarja e pajisjeve për kompostim shtëpiak nëpër amvisëri | plotësisht i zbatuar | KOM | Gjatë vitit 2022 BE/GIZ kanë shpërndarë gjithsej 1858 pajisje të kompostimit shtëpiak nëpër komuna të ndryshme të Kosovës, përderisa caku ishte vetëm 1500 pajisje kompostimi. Gjithashtu, me mbështetjen e BE/GIZ-it - komuna |

| Nr | Aktiviteti | Statusi i progresit | Institucioni përgjegjës | Sqarim i shkurtër i progresit |
|---|---|---|---|---|
| | | | | e Prishtinës gjatë muajit korrik të vitit 2022 e ka funksionalizuar Qendrën për Kompostim e cila do të jetë në funksion të pëmirësimit të gjendjes ekzistuese. |
| 4.3 | **Objektivi specifik: Krijimi i sistemeve të ripërdorimit dhe riciklimit të bazuara në konceptin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit** | | | |
| 4.3.1 | Hartimi dhe zbatimi i rregulloreve dhe skemave të nevojshme për mbeturinat e ambalazhit duke u bazuar në PZP-në | pjesërisht i zbatuar | MMPHI | Puna planifikuese është kryer gjatë vitit 2021 për zbatimin e një skeme të rimbursimit të depozitave (SKD) për ambalazhet e pijeve me mbështetjen e GIZ-it të ofruar nëpërmjet Asistencës Teknike të jashtme. Janë bërë analiza mbi kuadrin ligjor dhe hartimi i UA do te behet deri ne fund te vitit 2022. Vonesat në SKD janë kryesisht për shkak të situatës pandemike dhe ndryshimit të afateve. Më 30.06.2022 janë shpenzuar 39,640.72 EUR nga 91,078 EUR totale të akorduara për studimin përgatitor për SKD (duke mos mbuluar zbatimin e veprimeve përkatëse). Zbatimi i kësaj skeme SKD është planifikuar të përfundojë gjatë periudhës 2022-2024 |
| 4.3.1a | Sistemet e PZP-së në zhvillim e sipër | pjesërisht i zbatuar | BE/GDC (BGjZh) | Gjatë vitit 2022 janë përgatitur Termat e Referencës për sistemin e përgjegjësisë së zgjëruar të prodhuesit ku do të analizohen fraksionet e mbeturinave si në vijim: pajisjet elektrike dhe elektronike, bateritë dhe akumulatorët, vajrat dhe automjetet jashtë përdorimit, përderisa gjatë vitit 2023 do të zhvillohet plani i biznesit dhe do të hartohet korniza ligjore për krijimin e sistemit. |
| 4.3.2 | Hartimi dhe zbatimi i rregulloreve dhe skemave të nevojshme për MPEE-të, bateritë, AV-të, vajrat mbeturinë dhe gomat duke u bazuar në PZP-në | nuk ka filluar zbatimi | MMPHI | GIZ do të mbështesë MMPHI duke ofruar asistencë teknike në krijimin e skemave PZP për MPEE-të, bateritë, AV-të, vajrat mbeturinë dhe gomat në fund të jetës deri në fund të vitit 2024. Gjatë vitit 2022 është përzgjedhur kompania e cila do të ofrojë konsulencë në analizimin e gjendjes ekzistuese, si dhe do të përgatisë planin e studimit dhe ofroj mbështetje në hartimin e kornizës ligjore për krijimin e këtyre skemave. |
| 4.3.3 | Studimi fizibilitetit dhe hartimi i tij për qendrën e ndarjes dhe qendrën e kompostimit në Prizren | nuk ka filluar zbatimi | KOM | Ka filluar përgatitja e hartimit të termave të referencës. |

| Nr | Aktiviteti | Statusi i progresit | Institucioni përgjegjës | Sqarim i shkurtër i progresit |
|---|---|---|---|---|
| 4.3.6 | Studimi fizibilitetit dhe hartimi i tij për qendrën e ndarjes në Pejë | pjesërisht i zbatuar | KOM | Dizajni është përgatitur. |
| 4.3.9 | Studimi fizibilitetit dhe hartimi i tij për krijimin e qendrës së ndarjes në Prishtinë | nuk ka filluar zbatimi | KOM | |
| 4.3.12 | Studimi fizibilitetit dhe hartimi i tij për krijimin e qendrës së ndarjes në Mitrovicë | nuk ka filluar zbatimi | KOM | |
| 4.3.28 | Promovimi i vlerave të zinxhirit të ndarjes në burim dhe riciklimit | pjesërisht i zbatuar | BE/GDC (BGjZh) | Studimi fillestar dëshmoi se masat e veçanta të Ndarjes në Burim ndërlikojnë dhe mund të dëmtojnë përpjekjet që do të ndërmerren në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal për planet/sistemin e integruar të menaxhimit të mbeturinave të ngurta. |

